



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 174

dhjetor

2012

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr. 850, datë 6.12.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 199, datë 16.3.2011 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e monumentit të Heroit të Demokracisë dhe Pluralizmit, Azem Hajdari, në parkun pranë ndërtesës së Parlamentit të Ri, Tiranë”	10431
Vendim i KM nr. 870, datë 12.12.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për Entin Kombëtar të Banesave, si autoritet kontraktor.....	10431
Vendim i KM nr. 871, datë 12.12.2012	Për rishpërndarje fondesh buxhetore në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.....	10432
Vendim i KM nr. 873, datë 19.12.2012	Për lejimin e Portit Detar sh.a., Sarandë, për kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt “Riparim dhe montim i vinçit për shërbime portuale”, si autoritet kontraktor.....	10432
Vendim i KM nr. 876, datë 12.12.2012	Për shlyerjen, e një pjese të detyrimeve të prapambetura ndaj “Albtelecom” sh.a., për tarifat e shërbimit telefonik fiks për personat me aftësi të kufizuara.....	10433
Vendim i KM nr. 878, datë 12.12.2012	Për shtyrjen e afatit të njoftimit të kontratës së nënshkruar për procedurën e prokurimit publik, me objekt “Rrjeti i komunikimeve <i>on-line</i> i Shërbimit të Gjendjes Civile”, të kryer nga Ministria e Brendshme.....	10433
Vendim i KM nr. 879, datë 12.12.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si autoritet kontraktor.....	10435

Vendim i KM nr. 880, datë 19.12.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për disa institucione në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, si autoritete kontraktore.....	10435
Vendim i KM nr. 886, datë 12.12.2012	Për shtyrjen e afatit të shpalljes e të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për procedurat e prokurimit, të kryera nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si autoritet kontraktor.....	10436
Vendim i KM nr. 887, datë 12.12.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit publik për ndërtimin e linjës kabllore 20 kV të ndërtesës së re, për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, si autoritet kontraktor.....	10437
Vendim i KM nr. 889, datë 19.12.2012	Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve për kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës - Kavajë, nga pusshpimet e Çermës, loti III, (linjat e ujësjetllës nga PIK 235 (degëzimi në Kavajë) deri në depon e re 4000 m ³ në Arapaj, depo Arapaj 4000 m ³)”, si autoritet kontraktor.	10437
Vendim i KM nr. 890, datë 21.12.2012	Për rishpërndarje fondesh buxhetore, brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Shëndetësisë, në buxhetin e vitit 2012.....	10438
Vendim i KM nr. 892, datë 24.12.2012	Për ndryshimin e emërimit të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar në “Spitali Universitar i Traumës” dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të tij nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	10438
Vendim i KM nr. 893, datë 12.12.2012	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për disa institucione në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, si autoritete kontraktore.....	10440
Vendim i KM nr. 896, datë 12.12.2012	Për emërim në detyrë.....	10441
Vendim i KM nr. 897, datë 12.12.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 338, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar.....	10441
Vendim i KM nr. 898, datë 12.12.2012	Për miratimin e protokollit të bisedimeve, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin ekonomik për zhvillim, për vitin 2012.....	10442
Vendim i KM nr. 899, datë 12.12.2012	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e të taksimetra, për 8 bashki dhe 30 komuna.....	10453

Vendim i KM nr. 904, datë 12.12.2012	Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot.....	10455
Vendim i KM nr. 905, datë 12.12.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacione ushtarake në shtabe të ndryshme në Afganistan”, të ndryshuar.....	10469
Vendim i KM nr. 906, datë 12.12.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z. Bardhyl Agasi.....	10469
Vendim i KM nr. 907, datë 12.12.2012	Për nxitjen e investimeve private në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, të ndryshuar.....	10470
Vendim i KM nr. 908, datë 19.12.2012	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e taksimetrave, për 3 bashki dhe 7 komuna.....	10471
Vendim i KM nr. 909, datë 19.12.2012	Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike, për vitin 2013.....	10472
Vendim i KM nr. 910, datë 19.12.2012	Për lejimin e Hekurudhave Shqiptare sh.a., si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit “Faza II e projektit “Riaktivizimi i stacionit hekurudhor Kashar”” dhe për supervizion punimesh për fazën II të projektit “Riaktivizimi i stacionit hekurudhor Kashar”.....	10474
Vendim i KM nr. 912, datë 19.12.2012	Për autorizimin e “EKSSI” sh.p.k., për importin e mbetjeve të plastikës për qëllime riciklimi.....	10474
Udhëzim i MPPT nr. 19, datë 17.12.2012	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 749, datë 28.12.1999 “Për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme”.....	10475
Vendim i ERE nr. 161, datë 7.12.2012	Mbi shqyrtimin e aplikimeve të KESH sh.a., “Tec Vlorë” sh.a., OST sh.a., “Cez shpërndarje” sh.a., “Ulëz-Shkopet” sh.a., “Bistrica 1, 2” sh.a. për përditësimin e tarifave të gjenerimit, të furnizimit publik me shumicë, të shërbimit të transmetimit, të shërbimit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore (2012-2014).....	10478
Vendim i ERE nr. 162, datë 7.12.2012	Për disa ndryshime të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis KESH sh.a. dhe PVE të miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.....	10479

Vendim i ERE nr. 163, datë 17.12.2012	Mbi ankandin vjetor dhe mujor të kapaciteteve të interkonjeksionit të vitit 2013.....	10480
Vendim i ERE nr. 164, datë 18.12.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “A-91” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..	10481
Vendim i ERE nr. 165, datë 18.12.2012	Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. për lënien peng të aseteve të saj si kolateral pranë BERZH-it.....	10482
Vendim i ERE nr. 166, datë 18.12.2012	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Gjo Spa Power” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec-i “Lapaj”, si burim i rinovueshëm energjie.....	10482
Vendim i ERE nr. 167, datë 18.12.2012	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec-et “Lura 1”, “Lura 2” dhe “Lura 3”, si burim i rinovueshëm energjie.....	10483
Vendim i ERE nr. 168, datë 18.12.2012	Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k. për lënien peng të aseteve të saj si kolateral pranë Bankës Kombëtare Tregtare.....	10484
Vendim i ERE nr. 170, datë 18.12.2012	Për miratimin e marrëveshjes së shitjes së energjisë elektrike mes KESH sh.a. dhe “Energji Ashta” sh.p.k.....	10485

VENDIM
Nr. 850, datë 6.12.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 199, DATË 16.3.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGRITJEN E MONUMENTIT TË HEROIT TË DEMOKRACISË DHE
PLURALIZMIT, AZEM HAJDARI, NË PARKUN PRANË NDËRTESES SË
PARLAMENTIT TË RI, TIRANË**

Në mbështetje të neneve 95 pika 2, e 100 të Kushtetutës ne propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në titull dhe në pikën 1 të vendimit nr. 199, datë 16.3.2011, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... në parkun pranë ndërtësës së Parlamentit të Ri, Tiranë.” zëvendësohen me “... sheshin “Demokracia”, pranë Qytetit Studenti”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 870, datë 12.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Entit Kombëtar të Banesave të përfundojë procedurën e prokurimit me objekt “Përkthim, redaktim dhe përshtatje të eurokodeve nga 0 në 3”, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2012, brenda datës 20 dhjetor 2012.

Brenda këtij afati përfshihet edhe lidhja e kontratës përkatëse.

2. Ngarkohen Enti Kombëtar i Banesave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 871, datë 12.12.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE NË BUXHETIN E VITIT 2012,
MIRATUAR PËR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ndërmjet programeve, si më poshtë:

a) Në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, në zërin “Investime kapitale të brendshme” (TVSH, taksë doganore), të shtohet fondi prej 13 800 000 (trembëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekësh.

b) Në programin “Mbështetje për burimet natyrore”, në zërin “Investime kapitale të brendshme”, të shtohet fondi prej 8 000 000 (tetë milionë) lekësh.

c) Kjo shumë të përballohet nga pakësimet e fondeve në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, në vlerën 21 800 000 (njëzet e një milionë e tetëqind mijë) lekë, në të njëjtin zë shpenzimesh.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 873, datë 19.12.2012

**PËR LEJIMIN E PORTIT DETAR SHA SARANDË, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE
TË PROKURIMIT, ME OBJEKT “RIPARIM DHE MONTIM I VINÇIT PËR SHËRBIME
PORTUALE”, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Portit Detar sh.a. Sarandë, të vazhdojë të kryejë procedurat e prokurimit, me objekt “Riparim dhe montim i vinçit për shërbime portuale”, si autoritet kontraktor.

2. Ngarkohen Porti Detar sh.a. Sarandë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 876, datë 12.12.2012

**PËR SHLYERJEN E NJË PJESE TË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA NDAJ
“ALBTELECOM” SHA, PËR TARIFAT E SHËRBIMIT TELEFONIK FIKS PËR
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 10 të ligjit nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të nenit 12 të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar dhe të nenit 12 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nga fondet e vitit 2012 të programit të Mbrojtjes Sociale, artikulli 602 “Mallra e shërbime të tjera”, t’i paguajë “Albtelecom” sh.a., shumën prej 51 206 371 (pesëdhjetë e një milionë e dyqind e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e një) lekësh.

2. Fondi prej 51 206 371 (pesëdhjetë e një milionë e dyqind e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e një) lekësh të përdoret për shlyerjen e një pjese të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të nenit 12 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 83, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për tarifatat telefonike dhe për pagesat e energjisë elektrike nga personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar, “Albtelecom” sh.a.

3. Likuidimi i vlerës prej 51 206 371 (pesëdhjetë e një milionë e dyqind e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e një) lekësh të kryhet mbi bazën e dokumentacionit justifikues, të paraqitur nga “Albtelecom” sh.a., dhe të miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

4. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 878, datë 12.12.2012

**PËR SHLYERJEN E AFATIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR PËR
PROCEDURËN E PROKURIMIT PUBLIK, ME OBJEKT “RRJETI I KOMUNIKIMEVE
ON-LINE I SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE”, TË KRYER NGA MINISTRIA E
BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Brendshme, si organ qendror blerës, të realizojë, brenda datës 31 dhjetor 2012, procedurën e prokurimit, me objekt “Rrjeti i komunikimeve *on-line* i Shërbimit të Gjendjes Civile”, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, të përcaktuara në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihet publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor i përmendur në aneks për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneks

	Procedura e prokurimit	Fondi limit pa TVSH
I	Rrjeti i komunikimeve <i>on-line</i> i shërbimit të Gjendjes Civile	150 000 000

Aneks

	Autoriteti kontraktor	Fondi limit pa TVSH
I	Blerje pajisjeje elektronike ndarë në 6 lote	30 424 910
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për repartin “RENEA”	59,420,065
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Drejtorinë e Policisë të Qarkut Durrës	4,297,139
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Qendrën e Formimit Policor	113,536,233
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për repartin 712 FNSH Tiranë	44,919,433
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për repartin 731 FNSH Shkodër	32,705,484
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për repartin 752 FNSH Fier	28,461,600
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë Tiranë	4,100,149
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Delta Forcë Vlorë	27,597,041
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier	2,789,042
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Qendrën Spitalore të Burgjeve	3,807,935
	Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Spitalin Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”	3,664,978
	Total pa TVSH (Fondi limit)	325,299,099
II	Rrjeti i komunikimeve <i>on-line</i> i Shërbimit të Gjendjes Civile	150 000 000

VENDIM
Nr. 879, datë 12.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE, SI
AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si autoritet kontraktor, të përfundojë kryerjen e procedurave të prokurimit, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2012, në zërin “Shpenzime operative”, për objektin “Prodhim i deklaratës së interesave privatë dhe materialeve të tjera të printuara”, me fond limit 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekë.

2. Ngarkohen Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 880, datë 19.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
DISA INSTITUCIONE NË VARËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, SI
AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, që, brenda datës 25.12.2012, të përfundojë procedurat e prokurimit për furnizimin me mallra, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit, për vitin 2012, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe njoftimi i këtyre kontratave të nënshkruara në Agjencinë e Prokurimit Publik.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



ANEKSI 1

1. Qendra spitalore universitare “Nënë Tereza”

“Blerje kontrastesh dhe filma për imazherinë”

Fondi limit: 8 000 000 lekë pa TVSH (9.600.000 lekë me TVSH).

Procedura e parashikuar për blerjen e këtyre mallrave nuk është realizuar brenda afateve për vitin 2012 dhe aktualisht në QSUT ka nevoja të ngutshme për këto materiale.

“Blerje barnash për onkohematologji adult+pediatri (grupi A dhe B)”

Fondi limit: 32 948.300 lekë pa TVSH (39.537.960 lekë me TVSH).

Në shërbimin e onkologjisë adulte dhe pediatrike ka një kërkesë urgjente për disa barna, të cilat janë baza e shërbimit të onkologjisë, procedurat për blerjen e të cilave nuk u arritën të realizohen brenda afateve për vitin 2012 për mungesë konkurrence.

“Blerje barnash për shërbime të ndryshme me lote”

Fondi limit: 61 274.400 lekë pa TVSH (73.529.280 lekë me TVSH).

Procedurat për blerjen e disa medikamenteve për shërbime të ndryshme në QSUT (infektiv, kirurgji e përgjithshme, kardiokirurgji, neurokirurgji, pediatri) nuk i arritën të realizohen brenda afateve për vitin 2012. Nevoja për këto medikamente është e ngutshme në shërbimet përkatëse.

VENDIM

Nr. 886, datë 12.12.2012

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES E TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si autoritet kontraktor, për të përfunduar, deri më 20 dhjetor 2012, kryerjen e procedurave të prokurimit publik, me objekt “Rikonstruksion i sallave në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në godinën civile”. Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratës përkatëse, publikimi i fituesit dhe publikimi i njoftimit të kontratës së lidhur në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 887, datë 12.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK PËR NDËRTIMIN E LINJËS KABLLORE 20 KV TË NDËRTESESË SË RE, PËR
PROKURORINË E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, si autoritet kontraktor, të përfundojë, brenda datës 30 dhjetor 2012, procedurën e prokurimit, me objekt “Ndërtimi i linjës kabllore 20 kV për ndërtesën e re të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë”, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2012.

Brenda këtij afati përfshihen botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar, realizimi i kontratës dhe ekzekutimi i pagesave për këtë kontratë.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 889, datë 19.12.2012

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS - KANALIZIMEVE
PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, ME OBJEKT “FURNIZIMI ME
UJË I PLAZHEVE DURRËS - KAVAJË, NGA PUSHPIMET E ÇERMËS, LOTI III,
(LINJAT E UJËSJELLËSIT NGA PIK 235 (DEGËZIMI NË KAVAJË) DERI NË DEPON E
RE 4000 M³ NË ARAPAJ, DEPO ARAPAJ 4000 M³)”, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve, si autoritet kontraktor, të vazhdojë të kryejë, brenda datës 31 dhjetor 2012, procedurat e prokurimit, me objekt “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës - Kavajë, nga pusshpimet e Çermës, loti III (linjat e ujësjellësit nga PIK 235 (degëzimi në Kavajë) deri në depon e re 4000 m³ në Arapaj, depo Arapaj 4000 m³)”.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 890, datë 21.12.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE, BRENDË PROGRAMEVE TË
MIRATUARA PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, NË BUXHETIN E VITIT 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 07220 “Shërbimet e kujdesit parësor”, në artikullin 604 “Të tjera transferime korente të brendshme”, të pakësohet fondi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë.

b) Në programin buxhetor 07330 “Shërbimet e kujdesit dytësor” në artikullin 604 “Të tjera transferime korente të brendshme”, të shtohet fondi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë, për Spitalin Rajonal Fier, për mbulimin e shpenzimeve të dializës.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 892, datë 24.12.2012

**PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË SPITALIT USHTARAK QENDROR
UNIVERSITAR NË “SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS” DHE KALIMIN E
PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË TIJ NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515,
DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e emërimit të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar në “Spitali Universitar i Traumës” dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të tij nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë.

2. Spitali Universitar i Traumës është person juridik, publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili do të shërbejë si qendër kombëtare e traumës me funksion mjekësor, pedagogjik dhe kërkimor-shkencor.

3. Funksionet mjekësore, mësimore dhe kërkimore-shkencore të spitalit realizohen nga strukturat përkatëse në nivel shërbimi.

4. Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

5. Struktura dhe organika e spitalit përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

6. Ministria e Shëndetësisë kryen kompensimin financiar për shërbimin që kryen stafi akademik i Fakultetit të Mjekësisë në spital, bazuar në kontratat përkatëse.

7. Ministrisë së Shëndetësisë, në numrin e përgjithshëm të punonjësve, miratuar për vitin 2013, t'i shtohen 310 veta, numër i cili zbritet nga numri i përgjithshëm i punonjësve, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

8. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t'i shtohen përkatësisht këto fonde:

- për paga, 249 000 000 (dyqind e dyzet e nëntë milionë) lekë;
- për sigurime shoqërore e shëndetësore, 41 500 000 (dyzet e një milionë e pesëqind mijë) lekë; dhe
- në zërin “Mallra e shërbime”, 358 400 000 (treqind e pesëdhjetë e tetë milionë e katërqind mijë) lekë,

të cilat zbriten nga buxheti i parashikuar për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2013.

9. Të ardhurat dytësore të realizuara nga veprimtaria e spitalit dhe nga dhurimet, të përdoren totalisht nga vetë spitali, sipas udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë. Këto të ardhura të vlerësohen si të ardhura jashtë limitit.

10. Kontrolli fiziko-shëndetësor i personelit të Forcave të Armatosura dhe personeli ushtarak mjekësor i mbetur i Spitalit Universitar Qendror Ushtarak, me qëllim ruajtjen e aftësive profesionale, të vazhdojë të angazhohet në veprimtaritë e Spitalit Universitar të Traumës, bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

11. Të gjitha kontratat e lidhura nga Ministria e Mbrojtjes me palë të treta apo që kanë për objekt ambiente të caktuara të saj të vazhdojnë të zbatohen nga Ministria e Shëndetësisë, konform dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

12. Prona me nr. 51 “Reparti ushtarak 7010 SUQU”, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshilli të Ministrave, të ndryshuar.

13. Vendimi nr. 357, datë 18.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e statusit “Spitali Universitar” Spitalit Ushtarak Qendror” shfuqizohet.

14. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 893, datë 12.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
DISA INSTITUCIONE NË VARËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, SI
AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e disa institucioneve në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, të përfundojnë brenda datës 25 dhjetor 2012, procedurat e prokurimit për furnizimin me mallra, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2012, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Brenda këtij afati përfshihen dhe lidhja e kontratave përkatëse e njoftimi i këtyre kontratave të nënshkruara në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

1. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

Procedura e prokurimit: “Blerje materiale mjekimi për hemodializën, i ndarë në lote”

Fondi limit: 32 623 255 lekë pa TVSH (39 147 906 lekë me TVSH).

Kjo procedurë është e domosdoshme të zhvillohet për shkak të nevojave urgjente të krijuara si pasojë e rritjes së konsumit të materialeve të mjekimit të dializës nga ana e pacientëve që trajtohen pranë shërbimit të Nefrologji-Dializë-Transplant Renal në QSUT.

2. Spitali Rajonal Shkodër

Procedura e prokurimit: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje”

Fondi limit: 2 916 667 lekë pa TVSH (3 500 000 lekë me TVSH).

Kjo procedurë nuk është realizuar pasi është anuluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Procedurave të përqendruara në Ministrinë e Brendshme. Realizimi i kësaj procedure do të sigurojë lëndën e nevojshme për ngrohjen e ambienteve të spitalit Shkodër për periudhën e dimrit.

VENDIM
Nr. 896, datë 12.12.2012

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Klajda Gjoshaj emërohet Zëvendësministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 897, datë 12.12.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 338, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MODELIT TË TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 53 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin e modelit të tregut të energjisë elektrike, që i bashkëlidhet vendimit nr. 338, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të paragrafit të dytë të pikës 4.4, fjalët “... me çmime tregu ose furnizuesit publikë me shumicë me çmim të rregulluar dhe kontratë të miratuar nga ERE-ja ...” zëvendësohen me fjalët “... apo furnizuesi publik me shumicë dhe/ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, me çmime të vendosura në kontratën e shitblerjes të negociuar dhe të rënë dakord ndërmjet palëve”.

b) Në pikën 4.13, A, nënpika 5, fjalët “... e PPE-ve ...” hiqen.

c) Në fund të pikave 6.1, 6.2, 6.4 dhe 6.5 shtohen fjalët “... minimumi i lejuar i disbalancave zvogëlohet me 1 % për çdo vit, duke filluar nga viti 2013.”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 898, datë 12.12.2012

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE, NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK PËR ZHVILLIM, PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të bisedimeve, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin ekonomik për zhvillim, për vitin 2012, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Protokoll
i Bisedimeve për Bashkëpunimin Ekonomik për Zhvillim
midis
Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe
Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë
më 25 shtator 2012 në Tiranë

Hyrje

Bisedimet për Bashkëpunimin për Zhvillim midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë u zhvilluan në datën 25 shtator 2012 në Tiranë. Delegacioni i Republikës së Shqipërisë drejtohej nga Z. Nezir Haldeda, Zëvendës Ministër i Financave. Delegacioni i Republikës Federale Gjermane drejtohej nga Dr. Leo Kreuz. Listat e pjesëmarrësve të të dy delegacioneve janë bashkëngjitur si shtojcë 1 dhe 2. Listat e projekteve të Bashkëpunimit Teknik dhe Financiar janë bashkëngjitur si shtojcë 3 dhe 4.

Negociatat u zhvilluan në atmosferën e një bashkëpunimi të hapur dhe të mirë. Delegacionet bien dakord – bazuar në rezultatet e konsultimeve përgatitore të datës 5 tetor 2011 – për përdorimin e mjeteve financiare në dispozicion.

Rezultatet e bisedimeve janë paraqitur në vijim:

1. Kuadri i Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Dialogu Politik

Të dy palët bien dakord që të vazhdohet me sektorët kyç të deritanishëm.

Pala shqiptare raportoi mbi zbatimin e SKZHI 2007-2013 në sektorët kyç dhe procesin e afrimit të Shqipërisë me BE-në.

Pala gjermane raportoi se duke filluar nga fundi i këtij viti BMZ-ja do të caktojë një referente të Bashkëpunimit për Politikën e Zhvillimit në Ambasadën Gjermane në Tiranë. Në këtë mënyrë do të intensifikohet bashkëpunimi për politikën e zhvillimit. Referentja e Bashkëpunimit për Zhvillim do të jete përgjegjëse në të ardhmen për dialogun politiko-sektorial dhe do të mbështetet në sektorët kyç "Energjia" dhe "Furnizimi me Ujë / Pastrimi i Ujërave të Përdorura, Menaxhimi i Mbetjeve", nga zoti Eschemann (KfW) dhe në sektorin "Zhvillim i qëndrueshëm dhe social i ekonomisë", nga zoti Müller-Glodde (GIZ).

Pala gjermane theksoi, se në projektet e përbashkëta për zhvillim duhet të respektohen standardet transparente ndërkombëtare. Qëllimi i bashkëpunimit për politikën e zhvillimit është që prej tij të përfitojë e gjithë popullata shqiptare, të nxitë bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore dhe të mbështesë Shqipërinë në procesin e saj të mëtejshëm të afrimit në BE.

2. Dialogu dhe miratimet në sektorët kyç të bashkëpunimit dypalësh për zhvillim

2.1 Miratimet financiare dhe riprogramimet

Qeveria e Republikës Federale Gjermane angazhohet që për vitet 2012 dhe 2013 të vendosë në dispozicion të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë një shumë të re prej 31,1 Milion EURO për Bashkëpunimin Teknik dhe Financiar. Prej tyre, 22 Milion euro janë për projektet e Bashkëpunimit Financiar dhe 9,1 Milion euro për projektet e Bashkëpunimit Teknik. Për projektin "Programi për Mbrojtjen e Mjedisit në Liqenin e



Shkodrës” nëpërmjet Notës Verbale të datës 23.11.2011 janë vënë në dispozicion para konsultimeve qeveritare 5 Milion euro si kontribut financiar.

Krahas kësaj, në Bashkëpunimin Teknik do të riprogramohen 150.000 euro nga miratimet e viteve 2005 dhe 2008.

2.2 Paraqitje tabelare e miratimeve së bashku me riprogramimet

Projektet	BF/BT	BMZ-Nr.	Lloji	Ripro. (Euro)	Miratim i ri (Euro)
Hapësira realizimi					
Fondi i Studimeve dhe i Ekspertëve	BT	2002.3513.5	Shtesë	0,15 Milion	1 Milion
<u>Shuma: Hapësira realizimi</u>				<u>0,15 Milion</u>	<u>1 Milion</u>
Sektori kyç: Zhvillim i qëndrueshëm dhe social i ekonomisë					
Mbështetje për aftësinë konkurruese në zonat rurale	BT	2012.2061.5	Projekt i ri		2,5 Milion
Mbrojtja e Agrobiodiversitetit në zonat rurale të Shqipërisë	BT	2011.2195.3	Shtesë		0,8 Milion
Mbështetja e Integruar e Ekonomisë dhe Nxitja e Punësimit	BT	2010.2087.4	Shtesë		0,5 Milion
Programi për Arsimin Profesional	BT	2012.2473.2	Vazhdim projekti, faza tjetër		1,9 Milion
<u>Shuma: Zhvillim i Qëndrueshëm i Ekonomisë</u>				<u>0,00</u>	<u>5,7 Milion</u>
Uji i pijshëm, Menaxhimi i Ujërave, Ujërat e Zeza/Menaxhimi i Mbetjeve					
Programi për Infrastrukturën Komunale IV (M. Investimi)	BF	2012.6586.7	Vazhdim projekti		20 Milion Hua me kushte të favorshme
Programi për Infrastrukturën Komunale IV (Program)	BF	2012.7018.0	Vazhdim projekti		2 Milion masë shoqëruuese (Grant)
Reforma në Sektorin e Ujërave	BT	2012.2062.3	Vazhdim projekti		2,4 Milion
<u>Shuma: Uji i pijshëm, Menaxhimi i Ujërave, Ujërat e Përdorura/Menaxhimi i mbetjeve</u>					<u>24,4 Milion</u>
Shuma e përgjithshme					31,1 Milion

2.3 Sektori kyç “Energjia”

Të dy palët bien dakord, që furnizimi i besueshëm dhe eficient me energji elektrike është një kusht i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të Shqipërisë dhe të rajonit të Evropës Juglindore. Linja e tensionit të lartë midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, e cila u përrua me rastin e vizitës së Ministrit Federal për Zhvillim Niebel së bashku me Kryeministrin Berisha në gusht 2011, përbën një sukses të madh, pavarësisht vonesave në këtë projekt.

Edhe linja e planifikuar e transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë është shumë e rëndësishme për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike në Evropën Juglindore. Pala gjermane shpreh keqardhjen e thellë për zhvillimet në palën shqiptare gjatë procesit të tenderimit për ndërtimin e linjës 400 kV. Kjo çon në vonesa të mëdha, në rritje kostosh dhe rrezikon zbatimin e projektit në tërësi. Pala gjermane nënvijëzon, se duhet të respektohen standartet ndërkombëtare të tenderimit si edhe standartet teknike, në mënyrë që të mund të realizohet një projekt i suksesshëm (Ajo shpreh keqardhjen për pasojat që sjellin vonesat për Kosovën).

Pala shqiptare thekson rëndësinë e madhe të këtij projekti edhe për integrimin rajonal dhe shpreh gjithashtu keqardhjen për vonesat e krijuara. Pala shqiptare thekson, se ajo mbështet aktivisht përgatitjen dhe zbatimin e shpejtë e të mëtejshëm të projektit duke respektuar standartet ndërkombëtare të tenderimit, me qëllim arritjen e një projekti të suksesshëm dhe shfrytëzimin sa më efektiv të fondeve të akorduara.

Të dy palët bien dakord që për rakordimet e mëtejshme dhe përditësimin e Dokumentit Strategjik “Energjia”, të paraqitur gjatë Konsultimeve Qeveritare në muajin tetor 2011, duhet të priten zhvillimet aktuale në këtë sektor.

2.3.1 Bashkëpunimi financiar

Linja unazore e transmetimit 110-kV në Shqipërinë e Jugut (Përmirësimi i efijencës së energjisë) (2006.6550.5, 2008.6518.8)

Tenderimi i mallrave dhe i shërbimeve u realizua nga zbatuesi OST me ndihmën e konsulentit. Pala gjermane informoi se parimisht KfW-ja monitoron respektimin e marrëveshjeve dhe rregullsinë e procesit të tenderimit në përputhje me praktikën e zakonshme ndërkombëtare në të gjithë projektet e BF-së. Ky është një kusht për realizimin e suksesshëm të projektit.

Pala shqiptare informoi se klasifikimi i ofertuesve nga OST sh.a është përfunduar dhe i është dërguar për vlerësim KfW-së. KfW ka vlerësuar qëndrimin e OST sh.a dhe i është përgjigjur me propozime mbi procedurat e mëtejshme. OST sh.a është aktualisht duke konsideruar propozimet e KfW-së dhe shumë shpejt do ti përgjigjet zyrtarisht.

Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë) 2008.6519.6

Duke iu referuar deklaratës së përbashkët të OST dhe KOSTT ndaj KfW, se për Lot-in 1 dëshirohet anulimi i tenderit, pala gjermane thekson detyrimin e palës shqiptare për të respektuar direktivat e miratuara për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve.

Pala gjermane thekson më tej, se detyrimi kontraktual i palës shqiptare për të siguruar financimin e projektit do të shtrihej edhe tek kostot e shtuara në rast se do të krijoheshin kosto shtesë për shkak të një ritenderimi dhe për pasojë mjetet buxhetore të nevojshme për këtë duhet të vihen në dispozicion nga pala shqiptare. Në këtë kontekst pala gjermane bën me dije, se për financimin e kostove shtesë nuk do të vihen në dispozicion mjete financiare gjermane.



2.4 Sektori kyç: Zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë

Pala gjermane e mbështet Shqipërinë në këtë sektor kyç, veçanërisht në kuadër të Bashkëpunimit Teknik në sektorët e Ekonomisë dhe të Punësimit si edhe të Arsimit Profesional.

Të dy palët e kanë miratuar Dokumentin Strategjik për këtë sektor kyç gjatë konsultimeve në vitin 2011, në të cilën është plotësuar edhe aspekti i "Mbështetjes së Qëndrueshme për Turizmin" në kontekstin e mbrojtjes së resurseve natyrore.

Pala shqiptare prezanton linjat kryesore të Strategjisë për Turizmin.

Pala gjermane thekson se, si për afrimin me BE-në, ashtu edhe për rritjen e atraktivitetit të ekonomisë në Shqipëri, nevojiten edhe përpjekje të tjera për përmirësimin e kushteve, veçanërisht për luftën kundër korrupsionit dhe për sigurinë ligjore.

2.4.1 Bashkëpunimi Financiar

Rifincancimi i ndërmarrjeve të vogla në zonat urbane dhe rurale (2010.6571.3) dhe

Efiçenca e energjisë përmes sektorit bankar (2010.6622.4)

Pala gjermane vë në dukje se dy projektet e miratuara në vitin 2010 deri tani nuk janë zbatuar, sepse ende nuk janë përfunduar marrëveshjet qeveritare përkatëse. Projektet shërbejnë nga njëra anë për mbështetjen specifike të zonave rurale përfshirë agroindustrinë, dhe nga ana tjetër për mbështetjen aktive të investimeve për kursimin e energjisë. Pala shqiptare e kishte theksuar në mënyrë të përsëritur prioritetin e këtij sektori. Pala gjermane shprehet, se marrëveshjet qeveritare duhet domosdoshmërisht të përfundojnë, në mënyrë që të mund të vazhdohet me zbatimin e projekteve.

Pala shqiptare sqaroi arsyet se pse zbatimi i këtyre projekteve është një çështje kryesisht e sektorit bankar.

2.4.2 Bashkëpunimi Teknik

Programi: Arsimi Profesional, 2012.2473.2, (shtesë) 1.900.000,00 euro

Bashkëpunimi midis Ministrisë së Punës dhe Ministrisë së Arsimit është përmirësuar. Ky bashkëpunim duhet të sigurohet edhe në të ardhmen, në mënyrë që në këtë sektor të garantohen procese dhe përgjegjësi të qarta. Takimet e rregullta të nën-grupeve të punës, të cilët përbëhen nga Ministria e Punës, Ministria e Arsimit dhe donatorët në Arsimin Profesional, garantojnë një bashkëpunim të ngushtë në nivelin politik. Forcimi dhe intensifikimi i përfshirjes së ekonomisë (Dhomave të biznesit, etj.) është një prioritet i programit. Sipas këndvështrimit gjerman, bazë të rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të konceptit për modelin "Qendra Shumëfunksionale për Arsimin dhe Formimin Profesional në Kamëz" përbën dhënia e një statusi të veçantë kësaj qendre (dekret-akt ligjor): autonomi në sektorët e financës, personelit dhe menaxhimit, si dhe financim të mjaftueshëm për infrastrukturë shtesë (laboratorët dhe pajisje moderne).

Qeveria Federale Gjermane vendos në dispozicion të projektit edhe 1,9 Milion euro të tjera.

**Mbështetje për aftësinë konkurruese në zonat rurale, 2012.2061.5, (projekt i ri)
2.500.000,00 euro**

Qëllimi i projektit është dhënia e një kontributi për diversifikimin e ekonomisë rurale në Shqipëri. Të dy palët e përshëndesin këtë projekt të ri. Verifikimi i projektit bëhet me Fondin e Studimeve dhe të Ekspertëve.

Pala shqiptare shpreh interesin për të filluar sa më shpejt bashkëpunimin me Zyrën e GIZ Tiranë, për hartimin dhe zbatimin e projekteve konkrete në mbështetje të promovimit dhe zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm malor e rural.

Qeveria Federale Gjermane vendos në dispozicion të projektit 2.5 Milion euro.

Mbështetja e Integruar e Ekonomisë dhe Nxitja e Punësimit, 2010.2087.4, (shtesë)
500.000,00 euro

Projekti integron disa komponentë të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik me qëllimin për të rritur aftësinë konkurruese të SME-ve në sektorët e ekonomisë ushqimore, tekstilit, IT dhe turizmit. Krahas kësaj do të jepet mbështetje edhe për Agjensinë e Pagesave Bujqësore dhe strukturat institucionale në varësi, në mënyrë që të hartohen masa mbështetëse të BE-së, të ngjashme me IPARD-in (financim i kombinuar me BE-në). Kohëzgjatja e projektit është deri në qershor 2014. Pala shqiptare i kërkon palës gjermane të verifikojë mundësinë e vazhdimin të projektit.

Qeveria Federale Gjermane vendos në dispozicion të projektit fonde shtesë prej 0.5 Milion euro.

Mbrojtja e Agro-Biodiversitetit në zonat rurale të Shqipërisë, 2011.2195.3, (shtesë)
800.000,00 euro

Projekti jep një kontribut për mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të Biodiversitetit në rajonet e Alpeve të Shqipërisë. Të dy palët përshëndesin zgjerimin e aktiviteteve në Alpet Veriore të Shqipërisë. Këtu duhet të identifikohen dhe shfrytëzohen mundësitë për një bashkëpunim ekonomik rajonal.

Qeveria Federale Gjermane vendos në dispozicion të projektit një fond shtesë prej 0.8 Milion euro.

2.4.3 Instrumente të tjerë në sektorin kyç të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Ekonomisë

Aktualisht në këtë sektor kyç janë angazhuar 4 ekspertë të integruar (CIM): tek DIHA, tek Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe tek FASTIP. Për vitin 2012 janë parashikuar maksimalisht 3 ekspertë të rinj: në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës (Arsimi Profesional), në Universitetin Bujqësor dhe në Dhomën e Tekstileve.

2.5 Sektori kyç: Furnizimi me Ujë dhe Pastrimi i Ujërave të Përdorura, Menaxhimi i Mbetjeve

Pala shqiptare raportoi për arritjet dhe stadin aktual të Masterplanit. Të dy palët përshëndesin veçanërisht faktin që Masterplani parashikohet të miratohet nga Këshilli i Ministrave në tremujorin e fundit të vitit 2012.

Pala shqiptare përshendet angazhimin e palës gjermane për të marrë rolin e donatorit lider në sektorin e ujësjellës kanalizimeve në kuadër të iniciativës *"Pista e Shpejtë për Ndarjen e Punës"* (FTI-DoL).

2.5.1 Bashkëpunimi Financiar

Programi për Infrastrukturën Bashkiake IV, 2012.6586.7 (investim), 2012.7018.0 (masë shoqëruese); 20.000.000,00 euro (kredi për zhvillim), 2.000.000,00 euro (masë shoqëruese)



Të dy palët përshëndesin vazhdimin e financimit dhe të mbështetjes së investimeve në Programin IV – ashtu si edhe në programin e mëparshëm Infrastruktura Komunale III - nëpërmjet prioritetëve të masterplanit, i cili gjithashtu u mbështet nga BF.

Të dy palët përshëndesin faktin, që implementimi i **Programeve për Infrastrukturën Bashkiake I dhe II** është duke përparuar dukshëm. Pala gjermane inkurajon palën shqiptare në zbatimin sa më të shpejtë të projektit të Kamzës. Pala shqiptare njofton se nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizime është dërguar tek KfW dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë mendimi mbi zgjidhjen teknike dhe janë në pritje të opinionit të përbashkët të dy donatorëve. Pala shqiptare njofton që shumë shpejt do të merret vendimi mbi zgjidhjen teknike më optimale dhe të gjithëpranuar mbi çështjen në fjalë.

Të dy palët konstatojnë me kënaqësi se të gjitha ndërmarrjet e furnizimit me ujë janë duke punuar për përmirësimin e performancës së tyre, në mënyrë që të arrihen edhe objektivat e përcaktuara për zbatimin e projektit në Programet e Infrastrukturës Komunale. Për zbatimin e mëtejshëm të projektit përmirësimi në rritje është kusht i domosdoshëm.

Për fazën IV pala gjermane vë në dispozicion një kredi për zhvillim deri në 20 Milion euro dhe për masat shoqëruese 2 Milion euro (grant).

Qeveria Shqiptare është e angazhuar që brenda kohës limit dhe në përputhje me situatën makro ekonomike të procedojë për përthithjen e fondeve sipas prioritetëve të studimit të Master Planit të Furnizimit me Ujë dhe Largimin e Ujrave të Përdorura në Shqipëri.

Programi i Furnizimit me ujë në zonat rurale (Faza I- II) (2004 66 433 dhe 2008 65 998)

Pala shqiptare dhe pala gjermane bien dakort që rialokimet në këtë projekt të bëhen sipas rastit për të cilat do të bihet dakort ndërmjet palës shqiptare dhe Zyrës së KfW-së.

Pala shqiptare u vu në dijeni që për vijimin e investimeve shtesë është i domosdoshëm angazhimi edhe i një konsulentit tjetër.

Menaxhimi i mbetjeve në Juglindje të Shqipërisë (2008.6517.0, 2010.7017.6)

Pala shqiptare informon për stadin e nënshkrimit të marrëveshjeve të huave dhe financimeve, stadin e miratimit të lejes së ndërtimit për vendgrumbullimin dhe stadin e sigurimit të të drejtës së pronësisë mbi truallin e vendgrumbullimit.

Qeveria Shqiptare informon se mbetet e angazhuar për nënshkrimin e marrëveshjes së huasë dhe asaj financiare brenda vitit 2012. Pala gjermane kujtoi se marrëveshjet e huasë dhe e financimit duhet të nënshkruhen deri në fund të vitit 2012.

Pala shqiptare angazhohet gjithashtu në lidhje me përshpejtimin e procedurave të shpronësimit dhe të dhënies së lejes së infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e projektit.

2.5.2 Bashkëpunimi Teknik

Reforma në sektorin e ujit, 2012.2062.3, (vazhdim) 2.400.000,00 euro

Të dy palët përshëndesin vazhdimin e projektit. Në fazën tjetër projekti do përqëndrohet në mbështetjen e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (MPPT). Vazhdimësia e mëtejshme e projektit do të shqyrtohet në fund të vitit 2013.

Për këtë projekt Qeveria Federale Gjermane vë në dispozicion një fond prej 2.400.000,00 euro.

2.5.3 Bashkëpunimi i ardhshëm

Pala shqiptare shpreh dëshirën për mbështetje të mëtejshme në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Të dyja palët përshëndesin verifikimin e mundësive të bashkëpunimit teknik në sektorin e menaxhimit të mbetjeve me fondet për studime dhe ekspertë.

2.6 Bashkëpunimi jashtë sektorëve kyç

2.6.1 Bashkëpunimi financiar

Rezerva e Biosferës së Liqenit të Prespës (2001.6678.5)

Të dy palët theksojnë ecurinë e mirë të projektit dhe impaktin e tij. Bashkarisht ndahet mendimi se administrimi i pavarur i parkut përbën një premisë për garantimin e vazhdimësisë së tij. Pala shqiptare informon se po përgatitet ndarja e parkut nga administrata e pyjeve.

Fondi për studime dhe ekspertë V dhe VI (2001.7053.0, 2004.7055.9)

Pala gjermane bën me dije, se studimet për përgatitjen e projekteve fillimisht do të financohen nga mjetet financiare të mbetura nga dy Fondet e Studimeve dhe të Ekspertëve, para përdorimit të Fondeve të reja globale për Shqipërinë (nga i ashtuquajturi Fondi i Studimeve dhe i Konsulencës).

2.6.2 Bashkëpunimi Teknik

Fondi i Studimeve dhe Ekspertëve, 2002.3513.5, (shtese)

1.000.000,00 euro (VE) miratim i ri, 150.000 euro riprogramim

Në vitet 2010/2011 nga Fondi i Studimeve dhe Ekspertëve janë zbatuar projektet në vijim:

"Mbështetja për ndërtimin e Qendrës për Licencat e Energjisë", "Mbështetje për ekonominë kreative", "Kualifikimi i konsulentëve të IPARD".

Mjetet financiare të riprogramuara në Fondin e Studimeve dhe Ekspertëve me notën verbale të datës 21.09.2011 kapin shumën prej 150.000 euro dhe sipas përlogaritjeve përfundimtare të GIZ këtë vit do të kenë këtë përbërje: 85.000,00 euro nga projekti i përfunduar "Programi për Arsimin Profesional" (2008.2049.8) dhe 65.000 nga projekti "Fuqizimi i Shoqërisë Civile dhe i strukturave demokratike lokale" (2005.2038.7).

Të dy palët përshëndesin rritjen e këtij fondi si edhe fillimin e shpejtë të projektit "Turizmi kulturor në Gjirokastrë".

Pala gjermane vë në dispozicion mjete financiare me vlerë 150.000 euro për projektin "Turizmi kulturor në Gjirokastrë" si fazë të parë.

2.6.3 Instrumente të tjera, që mund të përdoren

Një ekspert i integruar CIM (Planifikimi i qytetit të Tiranës) deri në fund të gushtit 2013.

2.7 Projekte rajonale

Pala gjermane thekson se ajo vë në dispozicion mjete financiare shtesë të Bashkëpunimit Teknik për përfshirjen e Shqipërisë në programe rajonale, të cilët janë në dobi të të gjitha shteteve pjesëmarrëse. Selia e dy projekteve vijuese është Shqipëria.



Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në rajonin e Liqeneve të mëdhenj të Prespës, Ohrit dhe Shkodrës (PN 2011.2196.1)

Projekti rajonal do të realizohet në Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi. Qëllimi është përmirësimi i zbatimit të ligjeve, marrëveshjeve dhe planeve menaxhuese për ruajtjen e biodiversitetit dhe administrimin e qëndrueshëm të liqeneve ndërkufitarë të Ohrit, Prespës dhe Shkodrës. Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve vendase dhe bashkëpunimit rajonal projekti do të kontribuojë në përmirësimin e zbatimit të direktivave evropiane në rajonin e liqeneve të mëdhenj, sidomos të Direktivës Kuadër për Ujërat, Faunën dhe Florën, Direktivës për Habitatet e Florës dhe Direktivës për Mbrojtjen e Zogjve.

Përshtatja ndaj ndryshimeve të klimës në basenet e lumit Drin (PN: 2011.9774.8)

Projekti filloi në muajin dhjetor 2011. Shtetet pjesëmarrëse janë Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia dhe nga viti 2013 edhe Serbia. Qëllimi i projektit është përmirësimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimaterike në **basenet e lumit Drin**, sa i përket risqeve të shkaktuara nga përmbytjet dhe thatësira. Projekti vepron në **basenet e lumit Drin** në baze të Direktivave Kuadër të BE-së për Ujin, dmth. duke përfshirë të gjithë ujërat që derdhen atje. Qysh prej vitit 2012 në pjesën e poshtme të Drinit është duke u përgatitur një sistem alarmi për përmbytjet, Nexus Forst-Wasser. Me Bashkëpunimin Financiar (KfW; Siguria e Digave në Kaskadën e Drinit) është rënë dakord për një bashkëpunim të ngushtë në Veri të Shqipërisë, BF financon planin e evakuimit, GIZ mbështet zbatimin e tij në nivel vendor (nga 2013). Ka një rakordim të ngushtë me donatorët UNDP, WB, EU.

Krahas kësaj Shqipëria merr pjesë në aktivitetet e **Fondit të Hapur Rajonal** në Europën Juglindore:

- ORF Konsulencë për Ekonominë e Jashtme
- ORF Modernizimi i Shërbimeve Komunale
- ORF Konsulencë Ligjore
- ORF Efienca e Energjisë

Aplikimet për përdorimin e këtij fondi mund të paraqiten tek GIZ-ja si nga institucionet shtetërore ashtu edhe nga subjekte private (p.sh. Dhoma biznesi, Shoqata, Universitete). Zyra e GIZ-së në Shqipëri është e gatshme për sqarime të metejshme..

3. Instrumente dhe kontribute të tjera të Bashkëpunimit gjerman për Zhvillim

Pala gjermane thekson, se krahas bashkëpunimit dypalësh, i cili është në qendër të këtyre negociatave, ajo merr pjesë edhe si paguese kontributesh në programet dhe projektet e Bashkimit Evropian. Përveç kësaj Gjermania është kontribuesi i katërt nga madhësia në Bankën Botërore dhe kontribues me mbi 8,5% në BERZH. Gjermania mbështet gjithashtu financiarisht programet e Kombeve të Bashkuara si dhe organizatat e nënvarura apo të veçanta të OKB-së.

Pala shqiptare lutet që referuar këtyre organizatave, Gjermania të ndikojë në intensifikimin e zbatimit të programit "Një OKB" në Shqipëri.

Pala gjermane mbështet gjithashtu:

- "Krijimin e një marke-cilësie për qëndrueshmërinë me fokus tek efienca e energjisë dhe mjedisi për sipërmarrjet shqiptare të turizmit" në kuadër të Partneritetit-Publik-Privat.

- Punën me të rinjtë dhe fëmijët e Shoqatës Gjermane të Caritas-it në Tiranë dhe Cërrik.
- Përmirësimin e situatës sociale të të drejtave të njeriut në Veri të Shqipërisë nga Child Fund Deutschland e.V.
- Punën e fondacioneve politike Friedrich Ebert, Konrad Adenauer dhe Hanns Seidel në Shqipëri.

4. Kreditë mbështetëse të KfW-së

Përveç instrumentave aktualë të financimit të BF-së, KfW-ja për llogari të vet mund t'u vërë në dispozicion kredi apo asistencë si institucioneve shtetërore ashtu dhe kompanive private, kur bëhet fjalë për projekte të rëndësishme në kuadër të politikave të zhvillimit. Vëmendje kryesore i kushtohet projekteve në fushën e infrastrukturës sociale dhe ekonomike si dhe mbështetja e sektorit financiar. Për këto fusha KfW-ja vepron me porosi të posaçme të Qeverisë Federale së Gjermanisë. Për shkak të natyrës së projekteve që duhet të financohen, përpara akordimit të një kredie/ asistencë, Republika e Shqipërisë pranon se është e nevojshme të vërë në dispozicion të KfW-së pa vonesa dhe në vlerë të mjaftueshme valutë për shlyerjen e borxhit (transferimi i valutës). Pala shqiptare përpiqet të përmbushë këto kërkesa brenda afateve dhe garanton se nuk do ta trajtojë KfW-në ndryshe nga Institucionet e tjera Financiare Multilaterale.

5. Deklaratat dhe klauzolat përfundimtare

5.1 Kushtet për zhvillimin e projekteve

Të dy delegacionet bien dakord që të gjitha shërbimet e palës gjermane të parashikuara në këtë protokoll mund të realizohen vetëm atëherë, pasi

- Qeveria e Republikës Federale Gjermane të ketë marrë një vendim pozitiv pas shqyrtimit të projekteve/ programeve nga ana e KfW, GIZ dhe/ose organizate tjetër, të cilës i është ngarkuar zbatimi;
- Të jetë siguruar i gjithë financimi i projektit/programit;
- Të kenë hyrë në fuqi të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që pritet të miratohen (Marrëveshje Qeveritare dhe Marrëveshje për Programet/Projektet), Marrëveshjet e Financimit dhe Huave si edhe Marrëveshjet e Zbatimit me KfW dhe GIZ dhe eventualisht organizata të tjera zbatuese.

5.2 Përgatitja e projektit të BF-së

Të dy palët bien dakord, që për përgatitjen dhe shoqërimin e projekteve të BF-së të miratuara gjatë këtyre negociatave qeveritare të realizohen studime, ekspertiza dhe të angazhohen ekspertë, nëse është e nevojshme. Këto aktivitete do të rakordohen nga KfW-ja me autoritetet përkatëse. Mjetet financiare për këtë qëllim do të vihen në dispozicion nga Qeveria e Republikës Federale Gjermane krahas mjeteve financiare të miratuara gjatë Bashkëpunimit Financiar bilateral të paraqitur. Të dy palët do të raportojnë për zbatimin dhe rezultatet e aktiviteteve në kuadër të Konsultimeve apo Bisedimeve të ardhshme Qeveritare.

5.3 Klauzolë skadence dhe shkëmbimi; Fondet e mbetura

Pala gjermane thekson në mënyrë të veçantë se miratimet e marrëveshjeve të Bashkëpunimit Financiar dhe të Bashkëpunimit Teknik skadojnë tërësisht, nëse Marrëveshja e Zbatimit nuk do të ketë përfunduar brenda 8 viteve nga viti i miratimit, dmth.: Marrëveshjet e Huasë/Financimit në rastin e BF-së dhe Marrëveshjet e Zbatimit në rastin e BT-së. Për miratimet e vitit 2012 afati kohor përfundon në datën 31.12.2020.

Në rast se njëri apo disa nga projektet e përmendura nuk do të zbatohen, apo do të zbatohen pjesërisht, atëherë ai/ata mund të zëvendësohen me një projekt tjetër / me projekte të tjera në marrëveshje midis dy qeverive.



Shkëmbimi i projekteve nuk është i mundur tek projekti "Programi i Infrastrukturës Komunale IV" (PN 2012.6586.7).

Nëse në projektet e BT-së pas përmbushjes së të gjitha shërbimeve do të teprojnë mjete financiare, atëherë këto do t'i kalojnë Fondit të Studimeve dhe Ekspertëve, pa qenë e nevojshme një marrëveshje tjetër.

5.4 Deklarata antikorrupsion; Transparenca

Të dy delegacionet bien dakord që projektet e Bashkëpunimit të përzgjidhen dhe organizohen sipas kriterëve të politikës për zhvillim.

Qeveria e Republikës Federale Gjermane dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bien dakord për vlerësimin e pasojave negative të korrupsionit:

- Ai shkatërron qeverisjen e mirë.
- Ai shpërdoron financat e pakëta dhe ka ndikim shumë negativ në zhvillimin ekonomik dhe social.
- Ai rrezikon besueshmërinë e bashkëpunimit për zhvillim dhe mbështetjen e tij nga publiku dhe kufizon përpjekjet e të gjithë atyre, të cilët angazhohen për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Ai pengon konkurrencën e hapur dhe transparente në çmim dhe cilësi.

Të dy Qeveritë do të bashkëpunojnë ngushtësisht, në mënyrë që të garantojnë transparencë, detyrim për llogaridhënie dhe integritet gjatë përdorimit të financave publike dhe të përjashtojnë raste të mundshme të praktikave korruptive në bashkëpunimin e tyre për zhvillim.

Transparenca dhe detyrimi për llogaridhënie janë kushte thelbësore për arritjen e zhvillimit dhe për efektshmërinë e bashkëpunimit në kuptim të deklaratave ndërkombëtare (Deklarata e Parisit, Planveprimi Accra). Të dy delegacionet bien dakord që mund të bëjnë publike informacionet për qëllimet, programet, aktivitetet, rezultatet dhe pagesat e bera në baze të kushteve të rena dakort në projektet e zhvillimit dypalësh.

5.5 Pala gjermane përshëndet përpjekjet e mëdha të Qeverisë shqiptare për vazhdimin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ratifikimi i Protokollit të Palermos, krijimi i zyrës të koordinatorit vendas si edhe plani ndërkombëtar i veprimit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar si në kuadër të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore ashtu edhe në nisma të tjera rajonale konsiderohen si hapa të parë, të rëndësishëm për të luftuar veçanërisht trafikimin e qenieve njerëzore dhe për të garantuar standardet e të drejtave të njeriut për mbrojtjen e viktimave. Qeveria gjermane shpreson, se do të vijohet me një qasje multidisiplinore kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

6. Aplikimi i Gjermanisë për selinë e Fondit të Gjelbër të Klimës

Gjermania dëshiron ta zgjerojë më tej profilin e saj si një partner i denjë dhe i besueshëm në sektorin e ndryshimeve klimaterike. Pala gjermane ka nderin të bëjë me dije, se Gjermania ka paraqitur zyrtarisht aplikimin e saj tek Bordi i Fondit për të marrë selinë e Fondit të Gjelbër të Klimës.

Në vitet e ardhshëm Fondi synon që të zhvillohet në mekanizimin financues ndërkombëtar më të rëndësishëm në sektorin e ndryshimeve klimaterike.

Pala gjermane deklaroi se do të ishte një nder i madh për Gjermaninë, nëse do të mund të siguronte mbështetjen e Shqipërisë për aplikimin e saj.

Pala shqiptare mbajti shënim me kënaqësi dhe falenderoi për këtë aplikim të palës gjermane. Ajo deklaroi se do ta shqyrtoj me dashamirësi këtë propozim.

7. Negociatat e tjera Qeveritare

Negociatat e tjera të Bashkëpunimit për Zhvillim midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale Gjermane do të zhvillohen në vitin 2014 në Tiranë. Konsultimet e tjera për përgatitjen e Negociatave Qeveritare do të zhvillohen në vjeshtën e vitit 2013 në Tiranë. Data e saktë mbetet për t'u përcaktuar.

Tiranë, më 25 shtator 2012

Nezir Haldeda
Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Dr.Leo Kreuz
Për Qeverinë e Republikës Federale Gjermane

VENDIM

Nr. 899, datë 12.12.2012

PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 8 BASHKI DHE 30 KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 8 bashki dhe 30 komuna, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi, në vlerë 32 503 857 (tridhjetë e dy milionë e pesëqind e tri mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë, të përballohet nga Fondi i Kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



LIDHJA NR. 1

Nr.	Emri i NJQV-se	Vlera (ne leke)
1	Bashkia Ballsh	1,169,130
2	Bashkia Corovode	715,000
3	Bashkia Ura Vajgurore	1,130,250
4	Bashkia Fushe Kruje	711,500
5	Bashkia Belsh	598,548
6	Bashkia Manez	98,000
7	Bashkia Berat	2,914,122
8	Bashkia Pogradec	1,147,762
9	Bashkia Kucove	369,600
10	Komuna Cukalat	159,000
11	Komuna Cerrave	91,449
12	Komuna Vertop	496,750
13	Komuna Labinot -Fushe	1,390,167
14	Komuna Qender- Fier	482,284
15	Komuna Udenisht	825,750
16	Komuna Velabisht	1,537,133
17	Komuna Golem -Lushnje	1,694,700
18	Komuna Maminas	258,000
19	Komuna Allkaj	1,211,872
20	Komuna Kolonje-Lushnje	1,099,550
21	Komuna Xarre	291,000
22	Komuna Velipoje	498,700
23	Komuna Fier-Shegan	1,346,500
24	Komuna Paper	100,563
25	Komuna Qender-Bulgarec	95,000
26	Komuna Bubullime	731,500
27	Komuna Lumas	161,750
28	Komuna Bucimas	200,466
29	Komuna Hajmel	174,000
30	Komuna Gjergjan	441,000
31	Komuna Shirgjan	1,481,043
32	Komuna Thumane	269,825
33	Komuna Bogove	193,500
34	Komuna Tregan	547,389
35	Komuna Otlak	1,587,972
36	Komuna Bradashesh	3,129,214
37	Komuna Poshnje	1,332,562
38	Komuna Perondi	1,821,306
Shuma		32,503,857

VENDIM
Nr. 904, datë 12.12.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT
TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE, NË ZONAT PILOT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pikat 1 e 6, 20, pikat 3 e 4 dhe 42 e 42/1 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndihma ekonomike do të pilotohet, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, në qarqet Tiranë, Elbasan dhe Durrës.

Njësitë e qeverisjes vendore të këtyre qarqeve, ndahen në strate, sipas tabelës nr. 1, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Përfitojnë ndihmë ekonomike:

- a) familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
- b) jetimët të cilët nuk janë në institucione;
- c) prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;

ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;

d) viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

3. Për të përfitur ndihmë ekonomike kryefamiljari, së bashku me bashkëshorten paraqesin kërkesën pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/komunë, ku kanë vendbanimin, së bashku me:

a) Kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti;

b) Certifikatën familjare që lidhet me regjistrin e familjes për të gjithë ata persona që janë pjesë e së njëjtës gjendje familjare;

c) Dokumente të tjera të nevojshme, për të përcaktuar të ardhurat familjare;

ç) Vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesjes shoqërore, për rastet e parashikuara në shkronjën “ç” të pikës 2 të këtij vendimi, të lëshuar brenda 30 ditëve të fundit;

d) Urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, për rastet e parashikuara në shkronjën “d” të pikës 2 të këtij vendimi;

dh) Vërtetimin e gjykatës që bashkëshortët e familjes që paraqitet për të përfitur ndihmë ekonomike janë në proces zgjidhjeje martesore;

e) Kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, për rastet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij vendimi;

ë) Kopjen e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, për familjet që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, përfshirë edhe dokumentet e tjera të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

f) Certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës (tapinë e tokës), për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende.



4. Kërkesa dhe dokumentacioni i parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi, paraqitet e ndarë nga secili bashkëshort, për rastet kur janë në proces zgjidhjeje martese dhe ende nuk ka një vendim gjykatë të formës së prerë.

5. Administratori, në prani të kryefamiljarit dhe bashkëshortes, plotëson:

a) formularët për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe përmbledh informacionin për:

i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin;

ii) llojin e banesës;

iii) pasuritë/asetet shtëpiake;

iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera. Ky formular plotësohet një herë në vit;

b) deklaratën, sipas shtojcës 2, që është pjesë përbërëse e vendimit të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe që plotësohet çdo 3 (tre) muaj.

6. Administratorët shoqërorë janë të detyruar që dokumentet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, t'i ruajnë sipas legjislacionit për ruajtjen e dokumentacionit.

7. Ndryshimi i vendbanimit shoqërohet me transferim të ndihmës ekonomike brenda zonave të pilotimit.

8. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Ndarjen e qëllimshme të anëtarëve të familjes, kur nuk krijohet një kurorë e re, me përjashtim të rastit vajzë nënë.

b) Moslejimin e verifikimit të situatës sociale ekonomike në familje, edhe pas njoftimit të dytë nga ana e administratorit shoqëror.

9. Pas plotësimit të formularit “Aplikim për ndihmë ekonomike”, administratori shoqëror në bashki/komunë, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të çdo muaji, hedh në Regjistrin Kombëtar elektronik të dhënat e familjeve/individëve pretendues për ndihmë ekonomike, si dhe të dhënat e paraqitura nga vetë aplikuesi për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar ose shërbime të përkujdesjes shoqërore, sipas dokumentacionit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

10. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Sociale Shtetërore, pas ardhjes së vendimit për propozim, nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, sipas pikës 5 të nenit 42/1 të ligjit, verifikon të dhënat e hedhura në regjistër, konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe merr vendimin, përkatësisht:

a) nëse familja ose individ i nevojë i plotëson kriteret si përfitues i ndihmës ekonomike, të përcaktuara në këtë vendim të Këshillit të Ministrave, dhe vlerëson masën e përfitimit të tyre;

b) refuzon kërkesën nëse familja ose individ i nevojë nuk i plotëson kriteret si përfitues i ndihmës ekonomike, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave;

c) refuzon kërkesën kur ka deklarime të rreme gjatë plotësimit të formularit “Aplikim për ndihmë ekonomike”;

ç) përcjelljen e dosjes për vlerësim në KMCAP, për personat me aftësi të kufizuara;

d) dërgimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, për caktimin e ofruesit të shërbimit, për individët që kanë nevojë për shërbime të përkujdesjes shoqërore, kur ky shërbim nuk ofrohet në njësinë e qeverisjes vendore.

11. Për rastet e parashikuara në shkronjat “a” “b” dhe “c” të pikës 10 të këtij vendimi, i dërgohet kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore vendimi:

a) për të njoftuar kërkuar për përfitimin e ndihmës ekonomike;

b) për të kryer veprimet financiare, për kryerjen e pagesës, për përfituesit e ndihmës ekonomike.

12. Vendimi për trajtimin me ndihmë ekonomike përcaktohet duke përdorur një formulë të vazhdueshme, që përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës

ekonomike të familjeve, të tilla si: kushtet e jetesës, zotërimi i pasurive, të ardhurat nga remitancat. Formula e pikëzuar merr parasysh karakteristikat e ndryshme strukturore të familjeve urbane dhe rurale.

Ndihma ekonomike mund të jetë në masë të plotë ose të pjesshme. Përlllogaritja e masës së ndihmës ekonomike, për familjet e përzgjedhura në bazë të formulës së pikëzimit, bëhet sipas udhëzimit të miratuar nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Treguesit e vlerësimit për sistemin e pikëzimit janë sipas shtojcës 3, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

13. Njësia e qeverisjes vendore ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike, me fondet e siguruar nga të ardhurat e saj, edhe për periudha më të gjata se ajo e pilotimit, sipas këtij vendimi.

14. Masa e plotë e ndihmës ekonomike për familjen, pavarësisht nga përbërja e saj, nuk mund të jetë më e lartë se 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

15. Masa e ndihmës ekonomike, në muaj, për prindërit e fëmijëve të lindur:

a) trinjakë, është 3000 (tri mijë) lekë për çdo fëmijë;

b) katërnjakë, është 4000 (katër mijë) lekë për çdo fëmijë;

c) pesënjakë, është 5000 (pesë mijë) lekë për çdo fëmijë.

16. Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit është 3000 (tri mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre.

17. Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare është 3000 (tri mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet gjatë periudhës së vlefshmërisë të urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të përcaktuar në vendimin e gjykatës.

18. Për anëtarin e familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, invalid pune, nuk llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

19. Kur në përbërjen e strukturës së re, për efekt të llogaritjes së masës së ndihmës ekonomike, mbetet vetëm një anëtar, masa e ndihmës ekonomike për këtë të fundit është ajo e llogaritur për këtë anëtar.

20. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore, të përcaktuara në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

21. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrë udhëzimet e nevojshme në zbatim të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare pas përcaktimit të formulës së pikëzimit dhe ngritjes së Regjistrin Elektronik Kombëtar.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha



Aplikim për "Ndhim Ekonomike"

Shtojcë 1

Informacion i përgjithshëm

Ju falënderojmë që pranuat të merrni pjesë në këtë proces. Ky është një formular i aplikimit dhe intervista e solme në rastin tuaj merret si përzgjedhje për përfshirje në mundshëm.
Ky informacion do të jetë anonim dhe konfidencial.

"Ndihma ekonomike" synon të ndihmojë familjet dhe grupe shoqërore në nevojë të cilat nuk mund të sigurojnë nevojat bazë të jetesës si dhe për të zbutur varfërinë dhe përjashtimin social.

Plotësoni një formular aplikimi për çdo familje dhe mbledhni të gjitha dokumentet e nevojshme

Dokumentet e nevojshme dhe certifikatat përfshijnë:

- 1) Kopje e kartës së identitetit të aplikantit dhe e anëtarëve të tjerë të familjes që janë posedues të kartës së identitetit;
- 2) Çertifikata e lindjes ose dokumente të tjera të fëmijëve që nuk posedojnë karta identiteti;
- 3) Çertifikata të tjera që lidhen me regjistrin e familjes;
- 4) Dokumente të tjera të nevojshme për të përcaktuar të ardhurat dhe rrethanat/gjendjen familjare.

Ky formular aplikimi i ka pesë pjesë:

Pjesa 1a - Demografia e familjes
Pjesa 1b - Arsimit dhe punësimi
Pjesa 2 - Banesa
Pjesa 3 - Pasuritë/asetet shtëpiake
Pjesa 4 - Mbrojtja sociale
Pjesa 5 - Të ardhurat

Udhëzimet e përgjithshme

Përdor stilolaps të zi për të plotësuar formularin e aplikimit. Mos përdorni laps. Nëse bëni një gabim, hiqeni atë (me vizë) dhe shkruani përgjigjen e saktë pranë saj.
Nëse jeni duke përzgjedhur një përgjigje nga një listë përgjigjesh (për shembull, po ose jo) vini një kryq (X) në kutinë përkatëse.
Shënoni sasinë e të ardhurave të raportuara në lekë, dhe nëse aplikanti nuk ka të ardhura, vendosni "0" (zero) në kutinë përkatëse.
Plotësoni "kodin" e përshtatshëm në kutinë e caktuar kur plotësoni informacionin në lidhje me anëtarët e familjes;
Informoni aplikantin se ndoshta familja e tij do të vizitohet për të verifikuar informacionin e dhënë në formular.
Ju duhet të informoni aplikantin se ata duhet të japin informacion të saktë dhe të plotë në mënyrë që programi të vendosë nëse atagëzojnë të drejtën që të përfitojnë asistencë sociale dhe në rast se ajo jepet, ajo duhet të caktojë edhe shumën e përfitimeve.

Aplikanti

Anëtar i familjes, i cili është përzgjedhur për të përfaqësuar familjen, duhet të jetë në moshë madhore dhe të ketë marrë numrin e identifikimit kombëtar. Numri i identifikimit kombëtar i aplikantit është thelbësorë për shqyrtimin e aplikimit.

Përkufizimi i familjes

"Familja" është një grup individësh, të lidhur në marrëdhënie bashkëshortore, si dhe në marrëdhënie prind-fëmijë, në marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të familjes dhe në marrëdhënie të kujdestarisë mes personash që jetojnë nën të njëjtën çati.

A jeni i gatshëm të na lejoni të vizitojmë shtëpinë tuaj për pjesën e testit "Vizita në shtëpi"? Po ☐ Jo ☐

Emri i administratorit social
Numri i identiteti kombëtar të administratorit social
Emri i personit që hedh të dhënat
Vendi i intervistës

Data e intervistës Koha e fillimit Koha e përfundimit

Statusi i intervistës

/	/	/
---	---	---

Pjesa 1: Demografia e familjes

1 **Te dhena personale** Mbiemri _____ Emri _____

2 **Numri i identifikimit kombëtar të aplikuarit ashtu sipë tregohet në kartën e identitetit** _____

3 **Adresa** Kodi postar _____ Bashki/komune _____ Qarku _____
 Ju do të merri informacion _____ No. _____ Blok _____ Apartment _____
 me postë, por në disa raste, _____ (Bregdetar-1 : Qendror-2, Malor-3, Tirana-4) Zona _____
 do të dëshironim të _____ / pa disponueshem _____
 lidheshim me ju me telefon _____ Celulari _____
 Tel shtëpisë _____

4 **Gjuha** Në cilën gjuhë do të preferoni të merri informacion të mëtejshëm në lidhje me kërkesën tuaj? _____
 Në cilën gjuhë do të preferoni të merri informacion të mëtejshëm në lidhje me kërkesën tuaj? _____

5 **Grupi etnik** Shqiptar ☐ Grek ☐ Roma ☐ Maqedonas ☐ Malazezë ☐ Vllahe ☐ Te tjera ☐

6 **Certifikatë familjare**

A	B	C	D	E	F	G	H
EMRAT E ANETAREVE TË FAMILJES, BENI NJË LISTË TË PLOTË TË TË GJITHË PERSONAVE NË FJALË PARA SE SHKONI TEK PYETJET 4-10	Numri i identifikimit të personit (IDNP) - Tregoni N / A, nëse asnjë	Seksi: M 1 F 2	Data e lindjes (ditë/muaj/viti)	Moshë	Marrëdhëniet me kryefamiljarin:	Genderja civile	A vuan [EMR] nga një sëmundje kronike apo paafësi që ka zgjatur më shumë se 3 muaj (duke përfshirë edhe depresionin e rëndë)?
					Kryefamiljari 1 1. I martuar		
					Bashkeshortja/Partneri 2 2. Divorciar/ndarë		
					Fëmijajtënia i adoptuar 3 3. Jeloje se bashku		
					Nipër 4 4. I vekejushë		
					Mbesa 5 5. Beqar		
					Babamama 6		
					Motër / vella 7		
					SON, Dhender/Nuse 8		
					Kurnatë/kurnala 9		
					Gjyshi/gjyshe 10		
					Viehtë/viehtëra 11		
					Të afërm të tjerë 12		po 1
					Ju të afërm 13		jo 2
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							
11							



Pjesa 1b: Arsimi dhe Punësim

ID	Cili është arsimi më i lartë i arritur?		PYET TË GJITHË NE FAMILJE 16 VJEC E LARTE		Ne kete pune, ju jeni...	A keni të drejtë të përfitonit nga skema e sigurimeve shoqërore në këtë punë?	Sa ishte pagesa juaj e fundit apo fitimet NETO? (Nëse i intervistuari ende nuk është paguar, PYET: Çfarë pagese presin Cilën periudhë kohore mbulon kjo pagesë / apo fitim?)		Sa është pagesa/fitimi juaj i zakonshëm NETO? Çfarë periudhë kohore mbulon kjo pagesë? (merr parasysh kohën e 12 muajve të fundit, nëse ju keni filluar punë më pak se 12 muaj më parë, merr në konsideratë mesataren qysh nga fillimi)	
							Njesia ne kohe		Njesia kohore	
							Muaj		Muaj	
							15 dite		15 Dite	
						Javore		Javore		
						Ditore		Dite		
						LEKE		Njesia kohore		
						LEKE		Njesia Kohore		
1	Asnjë	0	A keni punuar në 4 javët e fundit?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar për kohësisht?	1 = Një punonjës i dikujt i cili nuk është anëtar i familjes					
2	Arsimi fillor 4 vjeçar	1	A keni punuar në 4 javët e fundit?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar për kohësisht?	2 = Punëtor me pagesë në një fermë familjare apo biznes tjetër					
3	Perfunduar 8/9 vite arsim fillor	2	A keni punuar në 4 javët e fundit?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar për kohësisht?	3 = Punëdhënës					
4	Arsim I mesëm I përgjithshëm	3	A keni punuar në 4 javët e fundit?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar për kohësisht?	4 = Punëtor me llogari më vete (i vetë-)					
5	Arsim Profesional 2-3 vjet	4	A keni punuar në 4 javët e fundit?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar për kohësisht?	5 = Punëtor i papaguar në fermë/biznes familjare					
6	Arsim profesional 4-5 vjet	5	A keni punuar në 4 javët e fundit?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar për kohësisht?	6 = te tjera ____					
7	Perfunduar universitetin ne Shqiperi	6	A keni punuar në 4 javët e fundit?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar për kohësisht?						
8	Perfunduar universitetin jashte Shqiperise	7	A keni punuar në 4 javët e fundit?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar për kohësisht?						
9	Pas universitar ne Shqiperi	8	A keni punuar në 4 javët e fundit?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar për kohësisht?						
10	Pas universitar jashte Shqiperise	9	A keni punuar në 4 javët e fundit?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar për kohësisht?						
11										

Pjesa 2: Banesa, Ujeldrita/gaz dhe mallra te qendrueshem

7	TIPI I BANSES SHTEPI PER NJE FAMILJE 1 BANESA ESHTË NJE NDERTESE ME 15 APARTAMENTE 2 BANESA ESHTË NJE NDERTESE ME ME SHUME SE 15 APARTAMENTE 3 TE TJERA (SPECIFIKO) 4	☐														
8	Numi i dhomave qe ka familja : (perjashto kuzhinen, ballkonin, korridoret dhe banjat)	☐														
9	CILA ESHTË GJENDJA E NJESISE SE BANIMIT? GJENDJE SHUME TE MIRE 1 E PERSHTATSHME PER JETESË 2 E PAPERSHTATSHME PER JETESË 3 NE RIKONSTRUKSION 4	☐														
10	Cfare tip banjoje ka banesa juaj? WC BRENDA SHTEPISE 1 2 OSE ME SHUME WC BRENDA SHTEPISE 2 WC JASHTË ME TUBACIONE 3 WC JASHTË, PA TUBACION 4 TE TJERA (SPECIFIKO) 5	☐														
11	A ka banesa juaj te meposhimet? (sheno kutine nese "PO") <table border="1"> <tr><td>KUZHINE TE NDARE</td><td>☐</td></tr> <tr><td>DUSH/VASKE TE NDARE</td><td>☐</td></tr> <tr><td>BALLKON OSE TERRACE</td><td>☐</td></tr> <tr><td>ANEKS GATIMI</td><td>☐</td></tr> <tr><td>PAPAFINGO</td><td>☐</td></tr> <tr><td>GARAZH</td><td>☐</td></tr> <tr><td>ASHENSOR</td><td>☐</td></tr> </table>	KUZHINE TE NDARE	☐	DUSH/VASKE TE NDARE	☐	BALLKON OSE TERRACE	☐	ANEKS GATIMI	☐	PAPAFINGO	☐	GARAZH	☐	ASHENSOR	☐	
KUZHINE TE NDARE	☐															
DUSH/VASKE TE NDARE	☐															
BALLKON OSE TERRACE	☐															
ANEKS GATIMI	☐															
PAPAFINGO	☐															
GARAZH	☐															
ASHENSOR	☐															
12	Cili eshte statusi i proneses se kesaj ndertese? PRONAR 1 PRONAR ME NJE HUA HIPOTEKARE PER NDERTESEN 2 E MARRE ME QERA NGA NJE INDIVID PRIVAT 3 E DHENE ME QERA NGA SHETI 4 JETOJ FALAS/PA PAGESE 5 TE TJERA (SPECIFIKO) 6	☐														
13	Cila eshte distanca e baneses nga.....me i afert? (Me kembe, vajtje/ose ardhje) <table border="1"> <tr> <td>STACION AUTOBUSI/ FUGONI</td> <td>MINUTA</td> </tr> <tr> <td>SHKOLLE FILLORE</td> <td></td> </tr> <tr> <td>AMBULANCE/DOKTOR</td> <td></td> </tr> </table>	STACION AUTOBUSI/ FUGONI	MINUTA	SHKOLLE FILLORE		AMBULANCE/DOKTOR										
STACION AUTOBUSI/ FUGONI	MINUTA															
SHKOLLE FILLORE																
AMBULANCE/DOKTOR																
14	Cili eshte burimi kryesor i ujit te perdorur ne kete familje? UJE I RRJEDHSHËM BRENDA BANESES 1 UJE I RRJEDHSHËM JASHTË BANESES 2 ÇEZEM PUBLIKE 3 AUTOBOT ME UJE 4 BURIM OSE PUS 5 LUM, LIQEN, PELLG UJOR APO DICKA E TILLE 6 TE TJERA (SPECIFIKO) 7	☐														



15	Çfare burimi ngrohjeje perdorni kryesisht ne familje ?																
	<table border="1"><tr><td>ENERGJI ELEKTRIKE</td><td>1</td></tr><tr><td>DRU ZJARRI</td><td>2</td></tr><tr><td>GAZ</td><td>3</td></tr><tr><td>NAFTE/ VAJGURI</td><td>4</td></tr><tr><td>QYMYR</td><td>5</td></tr><tr><td>ASNJE/JO NGROHJE</td><td>6</td></tr><tr><td>NGROHJE QENDRORE</td><td>7</td></tr><tr><td>TE TJERA (SPECIFIKO)</td><td>8</td></tr></table>			ENERGJI ELEKTRIKE	1	DRU ZJARRI	2	GAZ	3	NAFTE/ VAJGURI	4	QYMYR	5	ASNJE/JO NGROHJE	6	NGROHJE QENDRORE	7
ENERGJI ELEKTRIKE	1																
DRU ZJARRI	2																
GAZ	3																
NAFTE/ VAJGURI	4																
QYMYR	5																
ASNJE/JO NGROHJE	6																
NGROHJE QENDRORE	7																
TE TJERA (SPECIFIKO)	8																
A ka banesa matesin e vet te energjise elektrike ?																	
<table border="1"><tr><td>TE PERBASHKET</td><td>1</td></tr><tr><td>INDIVIDUAL</td><td>2</td></tr><tr><td>NUK KA MATES</td><td>3</td></tr></table>				TE PERBASHKET	1	INDIVIDUAL	2	NUK KA MATES	3								
TE PERBASHKET	1																
INDIVIDUAL	2																
NUK KA MATES	3																
16	A perdor familja juaj gaz?																
	<table border="1"><tr><td>PO</td><td>1</td></tr><tr><td>Jo</td><td>2</td></tr></table>			PO	1	Jo	2										
PO	1																
Jo	2																
17	Cili eshte qellimi i perdorimit te gazit?																
	<table border="1"><tr><td>(Sheno ato sipas rastesi)</td><td>NDRIÇIM</td><td> </td></tr><tr><td></td><td>NGROHJE</td><td> </td></tr><tr><td></td><td>GATIM</td><td> </td></tr><tr><td></td><td>APARATE TE TJERA ELEKTRIKE</td><td> </td></tr></table>			(Sheno ato sipas rastesi)	NDRIÇIM			NGROHJE			GATIM			APARATE TE TJERA ELEKTRIKE			
(Sheno ato sipas rastesi)	NDRIÇIM																
	NGROHJE																
	GATIM																
	APARATE TE TJERA ELEKTRIKE																

PJESA 3: Asetet familjare

18. Për çdo artikull të listuar më poshtë, ju lutem tregoni nëse familja juaj i zotëron ato apo jo?		A ka familja ARTIKULL
Lexoni të gjithë listën e artikujve		
		1 = PO
ARTIKULL	KODI	2 = NO

TV ME NGJYRA	101	
TV PA NGJYRA	102	
Vidio/DVD player	103	
Magnetofon/CD player	104	
Kamera, video kamera	105	
Frigorifer	106	
Frigorifer ftohës (ngjires)	107	
Makinë larëse	108	
Pjalalarese	109	
Sobë me gaz/energji elektrike	110	
Sobe me vajguri	111	
Sobe me dru zjarri	112	
Mikrovalë	125	
Kalorifer	113	
Gjenerator	114	
Makinë qepëse/thurrëse	115	
Kondicioner	116	
Bolier	117	
Komputer	118	
Aparat marrës satelitor/ aparat marrës kabllor	119	
Biçikletë	120	
Motoçikletë/ Motor me kubik të vogël	121	
Makinë/veturë	122	
Kamion	123	
Makinë Dumdum	124	

19. A zotëron toke familja juaj?		
Po	1	
Jo	2	

20. Cila është sipërfaqja e tokës?		
Metra katrorë		

21. A ka dikush në familjen tuaj ndonjë gjë të gjallë, shpezë, zgjua bletësh, ose që angazhohet në akuakulturë?		22. Sa kafshë, shpezë, zgjua bletësh, apo peshk të kultivuar ka familja juaj aktualisht?	
Po	1		
JO	2		
		TIPI	NUMRI

Lopë	
Derra	
Dele/dhi	
Shpezë	
Kuaj	
Gomar, Mushkë	
Dem	
Zgjua bletësh	
Lepuj	
Peshk (akuakulture)	



Pjesa 4: Mbrojtja Sociale

22A		22B	22C
	Në 12 muajt e fundit, a ka marrë ndonjë anëtar i familjes tuaj ndonjë pagesë nga burimet e mëposhtme? BENI PYETJE PER SECILIN BURIMI PARA SE TË VAZHDONI	Cila ishte shuma e pageses se familjes suaj e fundit?	Cili është numri i muajve që u referohet kjo pagesë?
	PO 1		
	JO 2		
	>>BURIMI TJETER		
BURIMI		LEKE	MUJ

1	Ndihma Ekonomike			
2	Pagesa per aftesin e kufizuar			
3	Pension pleqerie - Urban			
4	Pension pleqerie -Rural			
5	Pension suplementar			
6	Pension pa-aftesie - Urban			
7	Pension pa-aftesie - Rural			
8	Pension per merita te veçanta			
9	Pension per te mbijetuar - Urban			
10	Pension per te mbijetuar - Rural			
11	Asistence papunesie			
12	Perfitime per veterane te luftes			
13	Pagesa e lejes se lindjes (perfshin pagesat e marra gjate lejes se lindjes)			
14	Kujdesi social/ sherbimet per te moshuarit dhe per personat me pa-aftesi....			
15	Pagesa te lejes se semundjes (1-6 muaj)			
16	Te tjera ____ (specifiko)			

5-Te ardhura te tjera

		23	24
		Në 12 muajt e fundit a keni marrë pagesë nga burimet e mëposhtme (para ne dore apo forme tjeter pagese) ju apo ndonjë anetar tjetër i familjes tuaj?	Cila është shuma në total që ka marrë familja juaj në 12 muajt e fundit nga [BURIMI], përfshirë vlerën e ndonjë dhurate ose pagesë në formë mallrash?
		PO 1	
		JO 2	
BURIMI I TE ARDHURAVE			LEKE
1	Perfitime nga mbrojtja sociale (All SP)		
Remitancat/ dergesa ne te holla/ dhurata			
2	Remitancat/ dhurata nga te aferm jashte shtetit		
3	Dhurata nga te aferm ne Shqiperi		
4	Dhurata nga te aferm te tjere (përfshirë dhurata per nje ceremoni)		
5	Dhurata/ asistencë nga institucione		
Te ardhura nga qerata			
6	Qera nga toka /por jo toke bujqesore		
7	Qera nga apartamentet/shtepia		
8	Qera nga dyqani, dyqanet etj		
9	Qera nga makina, kamioni apo automjete te tjera		
Te ardhura nga shitjet e asetëve			
10	Shitje e pronës së patundshme (shtëpi, toke...)		
11	Shitje e mallrave te qendrueshme te familjes		
12	Shitje e asetëve te tjera		
Te ardhura te tjera			
13	Nga ndonje trashëgimi		
14	Fitime nga lotaritë apo bixhozi/kumari		
15	Te ardhura te tjera(_____)		
TE ARDHURA BUJQESORE			
16	Prodhime bujqesore te shitura /bimë bujqesore		
17	Produkte te shitura bujqesore s (mjaltë, pije alkoolike (raki, vere), ushqim te perpunuar etj		
18	Gjë e gjallë e shitur /shtazore		
19	Nen-produkte shtazore te shitura (veze, qumesht, djath, lesh, lekure bagetish, etj.)		
20	Te ardhura ne lekë ne dorë ose kontribut ne natyrë nga kooperativat bujqesore apo shoqata te tilla		
25	CILAT JANE TE ARDHURAT NETO MUJORE NE TOTAL TE FAMILJES në këtë moment (shuma ne total e të ardhurave të anëtarëve të familjes nga pagat / rrogat, mbrojtja sociale, pensionet, Asistenca)		
26	CILAT JANE SHPENZIMET TOTALE MUJORE TE FAMILJES		
27	A ka diçka tjetër që dëshironi të më thoni?		
28	Emrin e kryefamiljarit/bashkeshortes që do të administroj shumën e ndihmës		



Vlerësimi i intervistuesit

Vlerësim i përgjithshëm i pranisë fizike të personit që intervistohet (veshje, këpucë ..)

1. Ne gjendje shumë të keqe
2. Ne gjendje të keqe
3. Ne gjendje mesatare
4. Ne gjendje normale
5. Ne gjendje të mirë

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes ekonomike të familjes

Bazuar në eksperiencën tuaj të vlerësimit të familjeve të tjera dhe në krahasim me fqinjët, ku do ta vendosnit familjen sipas një shkalle standarte jetese nga 1-5, ku 1 është shumë e varfër, dhe 5 –e pasur mbi mesataren

1. Jashtëzakonisht e varfër
2. Shumë e varfër
3. E varfër
4. Pasuri mesatare
5. E pasur mbi mesataren

Çfarë karakteristika shihni ju në vlerësimin e situatës së mësipërme ekonomike për këtë familje?

4. Vlerësimi i besueshmërisë së informacionit të dhënë:

Cili është vlerësimi juaj për sinqeritetin e aplikantit në dhenien e informacionit ?

1. E vertetë (Po 1 Jo 2)

2. Nëse jo cili prej informacioneve të mëposhtme mendoni se mund të ri-kontrollohet (shëno në secilën)

- 2.1 Fsheh të ardhurat
- 2.2 Fsheh numrin e gjësë së gjallë
- 2.3 Fsheh hapësirën e jetesës /dhoma
- 2.4 Fsheh asetë të tjera
- 2.5 Fsheh banesën
- 2.6 Paraqet ndryshe informacionin individual për anëtarët e familjes
- 2.7 Fsheh që ka fëmijë në moshë madhore

5. Ndonjë koment tjetër, ju lutem shënoni me poshtë:

Shtojcë 2

DEKLARATE E PARAQITJES CDO 3-MUJ TE FAMILJES

Anëtarët madhore të familjes kërkuese për ndihme ekonomike paraqitet nga data 1 deri 15 çdo 3-muj pranë administratoreve shoqëror në bazë të ligjit Nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar.

Kryefamiljeri _____

Adresa e Banimit _____

PERBERJA DHE GJENDJA E FAMILJEVE

Muaji _____

Nr.	Emri Mbiemri	Datelindja Dite muaj vit	Lidhja me kryefamiljarin	Gjendja aktuale
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				

Emri Mbiemri i personit që do të administroj paratë _____

Shënim: Te kolona Gjendja Aktuale të shkruhet shënimi përkatës për çdo anëtar të familjes. I punësuar, i vetpunësuar, i papunë, pensionist, nxënës, student, fëmijë, ushtar, në spital, jashtë shtetit, në institucione etj.

Keni ndryshim në deklaratën e Gjendjes Ekonomike dhe Sociale të familjeve.

Po _____, JO _____. Në rast se Po _____ shkruani ndryshimet përkatëse

Firmat

Emri Mbiemri

Date _____ u mor ne dorezim nga Administratori Shoqeror

Firma _____



Rolet për variablat dhe koeficientet e përdorur në formulën e vlerësimit të komisionit

Shtojcë 3

	Simbolet:	
	variablat	koeficientet
Treguesve të madhësisë së familjes		
kryefamiljar	A	$coef'_a$
madhesia e familjes	B	$coef'_b$
perillogaritja e madhësisë së familjes	C	$coef'_c$
pjesa e fëmijëve	D	$coef'_d$
pjesa e antareve të moshuar	E	$coef'_e$
pjesa e antareve femra	F	$coef'_f$
niveli arsimor i antareve të familjes	G	$coef'_g$
Kushteve të jetesës		
nese banesa e familjes permban:	H	$coef'_h$
tualet brenda	I	$coef'_i$
kuzhine me vete	J	$coef'_j$
tarrace/ verande	K	$coef'_k$
garazh	L	$coef'_l$
depo	M	$coef'_m$
ka uje te rrjedhshem brenda	N	$coef'_n$
perdorin gaz	O	$coef'_o$
kane ngrohje qendrore me gaz apo energji	P	$coef'_p$
kane mates elektrik	R	$coef'_r$
dhomat per person	S	$coef'_s$
familja zoteron banesen	T	$coef'_t$
distanca nga banesa ne spital	U	$coef'_u$
Zotërimit të aseteve		
zoterojne TV me ngjyra	V	$coef'_{v1}$
frigorifer	V ₂	$coef'_{v2}$
video/DVD	V ₃	$coef'_{v3}$
lavatrice	V ₄	$coef'_{v4}$
lavastovilje	V ₅	$coef'_{v5}$
sobe elektrike apo me gaz	V ₆	$coef'_{v6}$
sobe me dru	V ₇	$coef'_{v7}$
kondicioner	V ₈	$coef'_{v8}$
bolier	V ₉	$coef'_{v9}$
kompjuter personal	V ₁₀	$coef'_{v10}$
satelit	V ₁₁	$coef'_{v11}$
makine	V ₁₂	$coef'_{v12}$
motor	V ₁₃	$coef'_{v13}$
Ardhura të tjera		
Remitanca/ dhurata nga te aferm jashte shtetit	W ₁	$coef'_{w1}$
Dhurata nga te aferm ne Shqiperi	W ₂	$coef'_{w2}$
Dhurata nga te aferm te tjere (perfshire dhurata per nje cerm	W ₃	$coef'_{w3}$
Dhurata/ asistence nga institucione	W ₄	$coef'_{w4}$
Te ardhura nga qerata		
Qera nga toka /por jo toke bujqesore	W ₅	$coef'_{w5}$
Qera nga apartamentet/shtepia	W ₆	$coef'_{w6}$
Qera nga dyqani, dyqanet etj	W ₇	$coef'_{w7}$
Qera nga makina, kamioni apo automjete te tjera	W ₈	$coef'_{w8}$
Te ardhura nga shitjet e aseteve		
Shitje e prones se patundshme shtepi, toke...	W ₉	$coef'_{w9}$
Shitje e mallrave te qendrueshme te familjes	W ₁₀	$coef'_{w10}$
Shitje e aseteve te tjera	W ₁₁	$coef'_{w11}$
Te ardhura te tjera		
Nga ndonje trashegimi	W ₁₂	$coef'_{w12}$
Fitime nga lotarite apo bixhozi/kumari	W ₁₃	$coef'_{w13}$
Te ardhura te tjera(_____)	W ₁₄	$coef'_{w14}$
Te ardhura bujqesore		
Prodhime bujqesore te shitura /bimë bujqesore	W ₁₅	$coef'_{w15}$
Produkte te shitura bujqesore s (mjaltë, pije alkolike	W ₁₆	$coef'_{w16}$
Gjë e gjallë e shitur /shtazore	W ₁₇	$coef'_{w17}$
Nen-produkte shtazore te shitura (veze, qumesht, dj	W ₁₈	$coef'_{w18}$
Te ardhura ne lekë ne dorë ose kontribut ne natyrë n	W ₁₉	$coef'_{w19}$
shkalla e varferise (harta e varferise 2008)	X	$coef'_x$
konstante	Y	$coef'_y$

VENDIM
Nr. 905, datë 12.12.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 532, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE NË SHTABE TË
NDRYSHME NË AFGANISTAN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes e të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1.2, të vendimit nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, nënndarja “ - Venddislokimi, 4 (katër) ushtarakë në Kabul dhe 1 (një) ushtarak në Herat, Afganistan.” zëvendësohet me “- Venddislokimi, Kabul, Afganistan.”.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.
 3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 906, datë 12.12.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT
TË Z. BARDHYL AGASI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 700 000 (shtatëqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Bardhyl Agasi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.



4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 907, datë 12.12.2012

**PËR NXITJEN E INVESTIMEVE PRIVATE NË SEKTORIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 27, DATË
19.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
VLERËSIMIT DHE TË DHËNIES SË KONCESIONEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjekti i furnizimit të energjisë elektrike dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes, në bazë të kërkesës së prodhuesit të energjisë elektrike, detyrohet të blejë energjinë elektrike të prodhuar, sipas nevojave të blerësit, në bazë të kontratës së shitblerjes të negociuar dhe për të cilën është rënë dakord ndërmjet palëve.

Kur blerësi është shoqëri me kapital 100% shtetëror, çmimi i blerjes do të jetë sa çmimi i importit të energjisë elektrike ditën e blerjes së energjisë, nëse ka, pa përfshirë tarifën e transmetimit ndërkufitar. Nëse nuk ka blerje, çmimi i energjisë do të jetë çmimi, me të cilin ky subjekt ka realizuar blerjen e fundit.

2. Marrëveshjet në fuqi ndërmjet prodhuesve të energjisë elektrike dhe KESH, sh.a. e/ose operatorit të sistemit të shpërndarjes, në të cilat parashikohet miratimi nga Enti Rregullator i Energjisë i çmimit të shitblerjes së energjisë elektrike apo detyrimi i KESH sh.a., sipas vendimit nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, të ndryshuar, mbeten në fuqi për aq kohë sa prodhuesit e energjisë elektrike dhe KESH sh.a., nuk bien dakord të ndryshojnë marrëveshjen ekzistuese.

3. Në pikën 1 të kreut IV të vendimit nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, të ndryshuar, bëhet këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë fjalët “... me fuqi të instaluar deri në 15 MW ...” shfuqizohen.

b) Paragrafi i tretë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për koncesionet e hidrocentraleve, kontrata përfshin kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për shitblerjen e energjisë elektrike. Kur e kërkon koncesionari, subjekti i furnizimit të energjisë elektrike, për pjesën e energjisë elektrike për të cilën është rënë dakord ndërmjet palëve për t’u blerë me çmim të rregulluar, detyrohet ta blejë energjinë elektrike të prodhuar sipas çmimit të përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë. Çmimi i shitjes së energjisë do të jetë i njëjtë për të gjithë koncesionarët dhe do të llogaritet nga Enti Rregullator i Energjisë e do të shpallet prej tij në fillim të çdo viti, në bazë të formulës së mëposhtme.”.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 908, datë 19.12.2012

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR
PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TAKSIMETRAVE, PËR 3 BASHKI
DHE 7 KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 3 bashki dhe 7 komuna, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ky fond, në vlerë 4 532 303 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e tre) lekë, të përballohet nga fondi i kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

Nr.	Emri i NJQV-së	Vlera (në lekë)
1	Bashkia Sukth	479,100
2	Bashkia Divjakë	803,000
3	Bashkia Poliçan	308,250
4	Komuna Udënisht	45,500
5	Komuna Rrajcë	335,202
6	Komuna Pirg	996,930
7	Komuna Roshnik	170,250
8	Komuna Pojan	963,196
9	Komuna Kuman	122,875
10	Komuna Shënkoll	308,000
	Shuma	4,532,303



VENDIM
Nr. 909, datë 19.12.2012

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE,
PËR VITIN 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit për menaxhimin e shpenzimeve publike, për vitin 2013, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Integritetit, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2013

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PERGJEGJES	VEPRIMI PERKATES
Dhjetor 2012	14	MF	Pergatit dhe paraqet ne KPS/KM Kalendarin e MSHP
Dhjetor 2012	26	KPS/KM	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP
Janar	11	MF	Paraqet ne KPS/KM Raportin mbi Vleresimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Fiskale
Janar	16	KPS/KM	Miraton Raportin mbi Vleresimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Fiskale
Janar	23	MF	Paraqet ne KM Programin Ekonomik dhe Fiskal 2013-2015
Janar	23	KM	Shqyrton dhe miraton Programin Ekonomik dhe Fiskal 2013-2015
Shkurt	8	MF	Paraqet ne KPS/KM tavanet e pergatitjes se PBA 2014-2016
Shkurt	13	KPS/KM	Shqyrton dhe miraton tavanet e pergatitjes se PBA 2014-2016
Shkurt	23	KM	Paraqet per informacion ne Kuvend Raportin mbi Vleresimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Fiskale si dhe Tavanet e pergatitjes se PBA 2014-2016
Shkurt	22	MF	Dergon Udhezimin e Pergatitjes se Buxhetit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme
Shkurt - Prill	22 Shkurt - 30 Prill	Njesite e Qeverisjes Qendrore	Pergatisin kerkesat e tyre buxhetore
Maj	1	Njesite e Qeverisjes Qendrore	Paraqesin ne MF kerkesat e tyre buxhetore
Maj	1 - 17	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kerkesave buxhetore
Maj	20 - 31	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat degjimore me Njesite e Qeverisjes Qendrore
Qershor	7	MF	Paraqet ne KPS/KM Raportin mbi Vleresimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Fiskale te Rishikuar
Qershor	12	KPS/KM	Miraton parashikimin e perditësuar Makroekonomik dhe Fiskal
Qershor	3-20	MF	Pergatit dokumentin e PBA 2014-2016 dhe tavanet e reja te shpenzimeve te PBA 2014-2016
Qershor	21	MF	Paraqet dokumentin e PBA 2014-2016 dhe tavanet e reja te shpenzimeve te PBA 2014-2016 per shqyrtim dhe miratim ne KPS/KM
Qershor	26	KPS/KM	Miraton dokumentin e PBA 2014-2016 dhe tavanet e reja te shpenzimeve te PBA 2014-2016
Korrik	5	MF	I paraqet Kuvendit per informacion dokumentin e PBA 2014-2016
Korrik	10	MF	Dergon Udhezimin Plotesues te Pergatitjes se Buxhetit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme
Korrik - Gusht	11 Korrik - 29 Gusht	Njesite e Qeverisjes Qendrore	Pergatisin kerkesat e rishikuara buxhetore
Gusht	30	Njesite e Qeverisjes Qendrore	Paraqesin ne MF kerkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	2-13	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kerkesave te rishikuara buxhetore
Shtator	16-27	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat degjimore me Njesite e Qeverisjes Qendrore
Tetor	4	MF	Paraqet ne KPS/KM parashikimin e perditësuar Makroekonomik dhe Fiskal
Tetor	9	KPS/KM	Miraton parashikimin e perditësuar Makroekonomik dhe Fiskal
Tetor	1-18	MF	Pergatit Projektbuxhetin e vitit 2014 si dhe dokumentin e rishikuar te PBA 2014-2016 dhe i paraqet per shqyrtim ne KPS/KM
Tetor	25	KPS/KM	Miraton Projektbuxhetin e Vitit 2014 si dhe dokumentin e rishikuar te PBA 2014-2016
Tetor	31	MF	Dergon per informacion ne Kuvend nje kopje te dokumentit te rishikuar te PBA 2014-2016, te miratuar nga KM
Tetor	31	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2014



VENDIM
Nr. 910, datë 19.12.2012

**PËR LEJIMIN E HEKURUDHAVE SHQIPTARE SHA, SI AUTORITET KONTRAKTOR,
PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT “FAZA II E PROJEKTIT
“RIAKTIVIZIMI I STACIONIT HEKURUDHOR KASHAR”” DHE PËR SUPERVIZION
PUNIMESH PËR FAZËN II, TË PROJEKTIT “RIAKTIVIZIMI I STACIONIT
HEKURUDHOR KASHAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Hekurudhave Shqiptare sh.a., të vazhdojë/kryejë procedurat e prokurimit me objekt “Faza II e projektit “Riaktivizimi i stacionit hekurudhor Kashar”” dhe për supervizion punimesh për fazën II të projektit “Riaktivizimi i stacionit hekurudhor Kashar”, brenda datës 30.12.2012.

2. Ngarkohen Hekurudha Shqiptare sh.a., dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 912, datë 19.12.2012

**PËR AUTORIZIMIN E “EKSSI” SHPK, PËR IMPORTIN E MBETJEVE TË PLASTIKËS
PËR QËLLIME RICIKLIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e “EKSSI” sh.p.k., për importin e mbetjeve të plastikës me kode doganore:
- GH 010 3915 -- mbetje, prerje dhe kthime prej plastike;
 - GH 011 ex 3915 10 -- prej polimereve të etilenit;
 - GH 012 ex 3915 20 -- prej polimereve të stirenit;
 - GH 013 ex 3915 30 -- prej polimereve të vinil kloridit;
 - GH 014 ex 3915 90 -- prej plastikave të tjera (polimere ose bashkime polimeresh);

dhe kodin B3-B3010 të Konventës së Bazelit, aneksi 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 550, datë 22.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”.

2. Sasia e mbetjeve të plastikës që do të importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 4 500 (katër mijë e pesëqind) tonë në vit.

3. Mbetjet do të importohen nga shtetet e Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi, Serbisë dhe vendet e Bashkimit Europian. Transporti do të bëhet në rrugë tokësore dhe detare, pasi të plotësohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për qëllime përdorimi, përpunimi dhe riciklimi”. Ambalazhimi i tyre të bëhet në paleta i presuar ose në thasë plastikë në përputhje me përcaktimin e bërë në aneksin 3, bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve “EKSSI” sh.p.k. dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në aneksin IV bashkëlidhur vendimit nr. 550, datë 22.8.2012 të Këshillit të Ministrave, dhe monitorimi i tyre të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve të plastikës nga “EKSSI” sh.p.k., është 1-vjeçare, (njëvjeçare) nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave ligjore të sipërpërmendura dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit publik, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve të plastikës nga “EKSSI” sh.p.k., pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon me shkrim me shtetet eksportuese dhe ato, ku do të bëhet kalimi transitor i mbetjeve, për autorizimet përkatëse në bazë të të cilave do të lejohet kalimi i kësaj sasive të mbetjeve të plastikës, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, konventë në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 19, datë 17.12.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 749, DATË 28.12.1999 “PËR
TRANSPORTIN RRUGOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, në zbatim të nenit 63, të kapitullit 5 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të nenit 19 të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të shkronjës “a” të pikës 9.7 dhe pikës 9.8 të kapitullit IX të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 21.8.1998 “Për rregullat e klasifikimit, emërtimit dhe transportimit rrugor të mallrave të rrezikshme”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit



UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 749, datë 28.12.1999 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“Mjetet me motor, rimorkiot, gjysmërimorkiot për transportin e disa mallrave të rrezikshme kalojnë kontrollin, në DPSHTRR, për plotësimin e kërkesave në lidhje me konstruksionin dhe miratimin e mjetit sipas pjesës 9 të marrëveshjes ADR, urdhëresës nr. 1, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimit nr. 5, datë 28.3.2012 “Për ekzaminimin e mjeteve dhe procedurat për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR.”.

2. Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“Para fillimit të procesit të ekzaminimit, përdoruesi, pronari ose drejtuesi i mjetit duhet të paraqesë certifikatën mod. 013, që lëshohet nga organi i miratuar nga ministri përgjegjës për tregtinë, për mjetet-cisternë, cisternat e çmontueshme, cisternat e transferueshme etj., veç të tjerave, përmban edhe rezultatet e inspektimit periodik, inspektimit të ndërmjetëm ose kontrolleve të veçanta, të përmendura në standardin europian SSHEN 12972:2007 dhe kontrolleve të përmendura në pikën 5.9.3 të urdhëresës nr. 1, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave.”.

3. Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“Mjeti që paraqitet për ekzaminim të gjendjes teknike në DPSHTRR duhet të jetë pa ngarkesë dhe i pastruar plotësisht. Në të kundërt kontrolli nuk fillon, përderisa përdoruesi, pronari apo drejtuesi i mjetit të plotësojnë këtë kusht.”.

4. Pika 4 shfuqizohet.

5. Pika 5 riformulohet si më poshtë:

“Mjeti që paraqitet për ekzaminim në DPSHTRR duhet të jetë i kompletuar me panelet dhe etiketat e identifikimit të klasës së rrezikut për mallin e rrezikshëm që do të transportojë. Në rast se ato mungojnë, mjetit i refuzohet kalimi në procesin e ekzaminimit deri sa ai të plotësojë këtë kusht.”.

6. Pika 8 riformulohet si më poshtë:

“Një kopje e certifikatës mod. 013 dorëzohet nga subjekti në organin kompetent të dhënies së licencës për ushtrimin e veprimtarisë, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar.

7. Pika 9 riformulohet si më poshtë:

“Organi kompetent i licencimit, krahas licencës, lëshon certifikatën e mjetit për transportin e mallrave të rrezikshme, sipas modeleve nr. 213 dhe 214 të udhëzimit nr. 20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor.”.

8. Modeli nr. 013 për cisternat bashkëlidhur udhëzimit nr. 749, datë 28.12.1999, ndryshohet me modelin nr. 013, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

9. Në fund të paragrafit të parë, të pikës 12, togfjalëshi “dëshminë përkatëse sipas modelit 015” zëvendësohet me togfjalëshin “certifikatën e trajnimit”.

10. Modeli 015 bashkëlidhur udhëzimit nr. 749, datë 28.12.1999, shfuqizohet.

11. Pas pikës 18 shtohen pikat 19, 20 dhe 21 si më poshtë:

“19. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) t’i kërkojë Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës (METE) të dhënat për organet e miratuara nga ministri që mbulon çështjet e tregtisë, që kanë të drejtën e kryerjes së inspektimeve të përmendura më sipër, për mjetet-cisternë, cisternat e çmontueshme, cisternat e transferueshme etj.

20. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

21. Udhëzimi nr. 12, datë 19.7.2012 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 749, datë 28.12.1999 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, shfuqizohet.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

Logo e organit të miratuar

Model 013
Formati A4

CERTIFIKATË E INSPEKTIMIT TË CISTERNËS AUTOMOBILISTIKE TË MALLRAVE TË RREZIKSHME
Nr. serial _____

Numri i certifikatës _____	Emri i prodhuesit _____
Subjekti _____	Vendi _____
Adresa _____	Numri shasisë _____
Data dhe lloji i inspektimit të fundit _____	Viti i prodhimit _____
_____	Targa _____

Tipi dhe marka e cisternës _____										
Ndarjet	1	2	3	4	5	6	7	8	total	
Trashësia e kërkuar e korpusit										mm
Trashësia e kërkuar e fundeve										mm
Trashësia e kërkuar e ndarjeve										mm
Presioni i provës										bar
Presioni maksimal i lejuar i punës										bar
Presioni i llogaritur min										bar

Kontrolli dokumenteve	O	Prova e hermeticitetit	O
Inspektimi brendshëm i cisternës	O	Prova e depresionit	O
Inspektimi i jashtëm i cisternës	O	Përcaktimi i kapacitetit ujqor	O
Prova e presionit hidraulik	O	Inspektimi i shasisë dhe pajisjeve	
Verifikimi i pajisjeve të punës	O	të strukturës së cisternave të zmontuesh	O
Valvola e sigurisë e taruar në bar (pres relativ)		Valvola e depresionit e taruar në bar (pres.r elativ)	
Inspektime dhe prova të tjera _____			

Vërejtje / difekte të konsiderueshme:

Inspektimi periodik	O	i pranueshëm	O	i papranueshëm	O
Inspektimi i ndërmjetëm	O	i pranueshëm	O	i papranueshëm	O
Kontroll jashtë radhe	O	i pranueshëm	O	i papranueshëm	O
ADR	O				

Inspektimi i ardhshëm i radhës _____	vendi dhe data _____
Inspektimi periodik	O Data, nënshkrimi dhe vula _____
Inspektimi i ndërmjetëm	O _____
Inspektimi i kryer konform SSHEN 12972	



Cisterna e mësipërme autorizohet për transportin e mallrave të rrezikshme të specifikuara në miratimin e saj. Mund të transportohen gjithashtu lëndët e tjera të rrezikshme të mëposhtme pasi të jetë kryer një kontroll jashtë radhe konform SSHEN 12972, 4.5.7.

Numri OKB	Emri i lëndës (për cisterna të specializuara) ose grupi i lëndëve (për cisterna shumëproduktesh)
-----------	--

VENDIM

Nr. 161, datë 7.12.2012

MBI SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE TË KESH SHA, “TEC VLORE” SHA, OST SHA, “CEZ SHPËRNDARJE” SHA, “ULËZ-SHKOPET” SHA, “BISTRICA 1, 2” SHA PËR PËRDITËSIMIN E TARIFAVE TË GJENERIMIT, TË FURNIZIMIT PUBLIK ME SHUMICË, TË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT, TË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE (2012-2014)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërive KESH sh.a., “TEC Vlorë” sh.a., OST sh.a., “CEZ Shpërndarje” sh.a., “Ulëz-Shkopet” sh.a., “Bistrica 1,2” sh.a. për përditësimin e tarifave të gjenerimit, të furnizimit publik me shumicë, të shërbimit të transmetimit, të shërbimit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore (2012-2014), sipas metodologjive përkatëse,

VENDOSI:

1. Të lërë në fuqi tarifat e miratuara nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 144, datë 7.12.2001 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore”, vendimin nr. 87, datë 29.6.2012 “Për rishikimin e tarifës për furnizuesin publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80, datë 15.6.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s”, vendimin nr. 151, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga TEC Vlorë sh.a. të FPSH, për periudhën e tretë rregullatore”, vendimin nr. 152, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Bistrica 1, 2” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”, vendimin nr. 153, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Lanabregas” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”, vendimin nr. 154, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”, vendimin nr. 146, datë 7.12.2012 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”, vendimeve nr. 147, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014”, vendimin nr. 148, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore”, vendimi nr. 149, datë 7.12.2012 “Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e reja me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2012”, vendimi nr. 150, datë 7.12.2012 “Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë

elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012”.

2. Bordi i Komisionerëve të ERE-s, do të përditësojë vendimet e parashtruara në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 30 qershor 2012.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesit për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 162, datë 7.12.2012

**PËR DISA NDRYSHIME TË KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE MIDIS KESH SHA DHE PVE TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 80, DATË
23.10.2012 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe nenit 9 të ligjit 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.13 germa “A”, pika 5 dhe germa “F”, pika 7, të modelit të tregut shqiptar të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 7.12.2012, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate KESH sh.a./FPSH dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë PVE, janë të licencuara nga ERE me vendimet respektive.

- Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë (PVE) është një marrëdhënie e rregulluar nga ERE.

- Është në autoritetin e ERE-s përcaktimi i të drejtave dhe i detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në “Modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH (FPSH) dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë (PVE)”, të miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



Teksti i ndryshimeve të kontratës:

Pas nenit 3.1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Pavarësisht detyrimit që ka KESH për të blerë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar nga shitësi, shitësi ka të drejtë të shesë të gjithë ose pjesë të energjisë së prodhuar subjekteve të tjera të ndryshme nga KESH, në sasi të dhe mënyrat e zgjedhura nga vetë shitësi”. Grafiku i livrimit për energjinë që do të shitet në tregun e parregulluar do të jetë në bandë sipas profilit 00:00-24:00.

Në nenin 5, pas pikës 5.2 shtohet pika 5.2/i, me këtë përmbajtje: “Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga KESH/FPSH impiantet prodhuese duhet të deklarojnë programet e tyre të livrimit dhe kontratat përkatëse për ditën në avancë”, si dhe planifikimin vjetor ku përcakton sasinë e energjisë elektrike që shitësi do të shesë në KESH sh.a., dhe në tregun e parregulluar të energjisë elektrike. Ky planifikim dërgohet në KESH sh.a. brenda datës 30 nëntor të vitit aktual për vitin pasardhës. Nominimi i programit përkatës do të bëhet në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.

Në nenin 5, pas pikës 5.3, shtohet pika 5.3/i me këtë përmbajtje: “Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga KESH/FPSH, ndaj impianteve prodhuese zbatohen rregullat e tregut mbi disbalancat”.

Në nenin 6, pas pikës 6.2 të shtohet pika 6.2/i, me këtë përmbajtje: “Kur prodhuesi/shitësi vendos të operojë si në tregun e rregulluar, si në tregun e parregulluar, impiantet prodhuese duhet të jenë të pajisura me sistem telematjeje me bazë orare të integruar me sistemin e matjes së OST-së”.

VENDIM

Nr. 163, datë 17.12.2012

MBI ANKANDIN VJETOR DHE MUJOR TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT TË VITIT 2013

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X pika 2 të “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.12.2012, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

1. OST sh.a. të shtyjë zhvillimin e ankandit vjetor për kapacitetet ndërkufitare deri në datën 22.1.2013.

2. OST sh.a. të alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin janar 2013, në drejtim importi, për kryerjen e importit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistem.

3. OST sh.a. të zhvillojë ankand për muajin janar 2013 për kapacitetet e mbetura ndërkufitare, në drejtimin e importit, pas plotësimit të pikës 2 të këtij vendimi.

4. OST sh.a. të zhvillojë ankandin për muajin janar 2013 për kapacitetet ndërkufitare në drejtim eksporti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 164, datë 18.12.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “A-91” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 8 dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “A-91” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “A-91” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10 gjerat “a” “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “A-91” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 165, datë 18.12.2012

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HYDRO POWER PLANT OF KORÇA”
SHPK PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL PRANË BERZH-IT**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6 dhe 7 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës me seri PV10P “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të aseteve si kolateral nga shoqëria “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. pranë BERZH-it, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1.1 dhe 1.2. Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit. (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte.)

- Neni 7 pika 1.3 germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”. Përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)

- Neni 7 pika 2, 3, 4 dhe 5. (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k., për lënie peng si kolateral të aseteve të saj pranë BERZH-it.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 166, datë 18.12.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“GJO SPA POWER” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HEC-I
“LAPAJ”, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të

miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, nenit 18 pika 1 germa “d” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21 datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gjo Spa Power” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga HEC-i “Lapaj”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Gjo Spa Power” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Gjo Spa Power” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga HEC-i “Lapaj” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 167, datë 18.12.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË “ERDAT LURA” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HEC-ET “LURA 1”, “LURA 2” DHE “LURA 3”, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, nenit 18 pika 1 germa “d” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Erdat Lura” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec-et “Lura 1”, “Lura 2” dhe “Lura 3”, si burim i rinovueshëm energjie,



konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Erdat Lura” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme” si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga hec-et “Lura 1”, “Lura 2” dhe “Lura 3”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 168, datë 18.12.2012

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HEC VLUSHE” SHPK PËR LËNIEN PENG TË ASETVE TË SAJ SI KOLATERAL PRANË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 10 pika 1 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës me seri PV10P “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të aseteve si kolateral nga shoqëria “Hec Vlushe” sh.p.k. pranë Bankës Kombëtare Tregtare, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7 pika 1.1 dhe 1.2. Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit. (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte.)

- Neni 7 pika 1.3 germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”. Përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)

- Neni 7 pika 2, 3, 4 dhe 5. (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Hec Vlushe” sh.p.k. për lënie peng si kolateral të 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 170, datë 18.12.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE MES
KESH SHA DHE “ENERGJI ASHTA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 8.1.1 të marrëveshjes së shitjes së energjisë elektrike mes “Energji Ashta” sh.p.k. dhe KESH sh.a., miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1363, datë 17.10.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e shitjes së energjisë elektrike mes KESH sh.a. dhe “Energji Ashta” sh.p.k., miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1363, datë 17.10.2008 (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë shoqëritë e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.1.2013
Doli nga shtypi më 4.1.2013

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 62 lekë